



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 8335/1 Prot.

Tiranë, më 24.12. 2025

URDHËR

Nr. 619, datë 24.12.2025

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E
KOLEGJIT UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 33, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të urdhrin nr. 580, datë 11.11.2025, të Ministrit “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Armela Baka”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në statutin e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, të miratuar me urdhrin nr. 556, datë 24.11.2016 e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e statutit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” i ndryshuar, sipas propozimeve të vendimit nr. 08, datë 28.10.2025 të Bordit të Administrimit dhe vendimit nr. 10, datë 04.11.2025, të Senatit Akademik, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri, 9 (nëntë) faqe.
2. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, të miratohen në zbatim të statutit dhe kuadrit ligjor në fuqi.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin në Ministrinë e Arsimit dhe Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ARMELA BAKA



KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"
University College "Canadian Institute of Technology"

Licencuar me VKM nr.781, datë 10.11.2011
Akredituar me Urdhrin nr. 06, datë 27.01.2023
Bordi i Administrimit / Board of the Administration

Nr. 8 Prot.

Tiranë më 28.10.2025

BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM QARKULLUES

Nr. 08, datë 28.10.2025

"Mbi disa shtesa dhe ndryshime të propozuara në Statutin e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", të ndryshuar.

Në bazë të nenit 33/2 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në përmbushje të rekomandimeve të nëngrupit të punës të ngritur nga MAS për verifikimin e ligjshmërisë të veprimtarisë së IAL-ve..., në vijim të rekomandimeve të MAS, dërguar me shkresën Nr. 4930 Prot, datë 01.08.2025 dhe shkresën Nr. 4930/2 Prot, datë 15.10.2025, bazuar në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, Bordi i Administrimit:

VENDOSI:

Në Statutin e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 1, pika 5 ndryshon në "5. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", i nënshtrohet akreditimit periodik institucional dhe programeve të studimit sipas legjislacionit për arsimin e lartë";
2. Në nenin 2, pika 2, shkronja b) ndryshon në "b) për të përfituar fonde nga pronari, shteti, organizata të tjera si dhe donacione";
3. Në nenin 3, fjalia e fundit ndryshon në "Selia e institucionit është e vendosur në Rr. "Xhanfize Keko", Tiranë";
4. Në nenin 7 shtohet në fund paragrafi me këtë përmbajtje: "Kolegji Universitar 'Instituti Kanadez i Teknologjisë' ka të drejtë të krijojë në strukturën e tij autoritete dhe organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e tij.";
5. Neni 8 ndryshon në:

"Neni 8

Organet Drejtuese, Autoritetet Drejtuese, si dhe organe të tjera

1. Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", organ më i lartë drejues akademik është:





- a) *Senati Akademik;*
2. **Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" organet kolegjiale janë:**
 - a) *Rektorati;*
 - b) *Këshilli i Fakultetit;*
 - c) *Dekanatet;*
 - d) *Këshilli i Etikës.*
3. **Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" organe të tjera akademike janë:**
 - a) *Asambletë e personelit akademik të njësive kryesore;*
 - b) *Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin;*
 - c) *Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore;*
 - d) *Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore;*
 - e) *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.*
4. **Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", autoritetet drejtuese akademike janë:**
 - a) *Rektori;*
 - b) *Dekanët;*
 - c) *Përgjegjësit e Departamenteve;*
 - d) *Përgjegjësit e Qendrave Kërkimore- Shkencore.*
5. **Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" organi më i lartë administrativ është:**
 - a) *Bordi i Administrimit.*
6. **Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" autoritetet drejtuese administrative janë:**
 - a) *Administratori i Kolegjit;*
 - b) *Administratorët e Njësive Kryesore."*
6. Në nenin 9, në pikën 2 bëhen këto ndryshime:
 - *Në shkronjën e), folja "miraton" zëvendësohet me foljen "harton";*
 - *Pas shkronjës m) shtohet shkronja m/1) me përmbajtje: "m/1) zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit";*
7. Në nenin 10, në pikën 1 fjala "Udhëzimin' zëvendësohet me fjalën "Rregulloren".
8. Në nenin 11 shtohet pika "7" me këtë përmbajtje: "7. Mandati i anëtarit të ri është plotësues.".
9. Në nenin 16 në pikën 1 shfuqizohet fjala "ekzekutiv".
10. Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:
 - *Përpara paragrafi 1 shtohet paragrafi: "Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore përkatëse.";*
 - *Në paragrafin 1, shkronja a) ndryshon në: "*
 - a) *zgjedh përfaqësuesit e njësive kryesore (Fakultetit) përkatëse si anëtarë të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve në Rregulloren për zgjedhjet";*



- shkronja b) ndryshon në: Anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore në institucionet e arsimit të lartë vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësive kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.”
- shkronja c) shfuqizohet

11. Në nenin 26 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: “1/1. Anëtarët e Këshillit të Fakultetit vetëkandidohen/propozohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësive kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.”

- Pika 3 ndryshon në: “3. Këshilli i Fakultetit drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga trupa akademike me kohë të plotë të njësive kryesore. Këshilli përbëhet nga jo më shumë se 7 anëtarë, prej të cilëve 2 janë drejtues të njësive bazë dhe një prej tyre është përfaqësues i studentëve të njësive kryesore.”

12. Pas nenit 27, shohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

Qendrat për zhvillim, inovacion dhe trajnime profesionale

1. Pranë Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” krijohen qendra për zhvillim, inovacion dhe trajnime profesionale, të cilat funksionojnë si struktura ndihmëse në varësi të Administratorit.
2. Qendrat e krijuara janë:
 - a) Qendra për Siguri Kibernetike dhe Inteligjencë Artificiale (CCAI);
 - b) CIT HUB – Qendër për Start-Upe dhe Laborator Inovacioni;
 - c) Qendra për Zhvillim dhe Trajnim të Avancuar në Shqipëri (C-DATA).
3. Këto qendra kanë për qëllim:
 - a) të ofrojnë trajnime profesionale, kurse të specializuara dhe shërbime praktike për studentë dhe publikun;
 - b) të nxisin zhvillimin teknologjik, inovacionin dhe sipërmarrjen studentore;
 - c) të realizojnë bashkëpunime me institucione dhe partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fusha të interesit.
4. Organizimi i brendshëm, drejtimi, mënyra e financimit dhe raportimit të tyre përcaktohen në rregullore të veçanta, të miratuara nga Senati Akademik.”

13. Në nenin 28 bëhen këto ndryshime:

- pika 2 ndryshon në: “2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore (një për secilën njësi); 1 (një) personel i administratës, 1 (një) përfaqësues nga studentët që propozohet nga Këshilli Studentor, dhe 1 (një) ekspert i sigurisë së cilësisë, minimalisht me dy vite eksperiencë, që drejton njësinë. Anëtarët e Njësive miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.”
- Në pikën 3 fjala ‘1 jashtëm’ pas fjalës ‘eksperti’ shfuqizohet

14. Në nenin 30, në pikën 2 pas shkronjës gj) shtohen shkronjat me përmbajtjen e mëposhtme:

- h) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikeqyr zbatimin e tij;
- i) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të



- institucionit dhe mbikqyr zbatimin e tyre;*
- j) *vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit me një institucion tjetër;*
- k) *miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njërive përbërëse të institucionit."*
15. Në nenin 31, pika 1, fjalia e parë ndryshon në: "Bordi i Administrimit përbëhet nga pesë (5) anëtarë."
16. Në nenin 32 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje: "6. Mandati i anëtarit të ri është plotësues."
17. Në nenin 34, pika 1 ndryshon në: "1. Bordi i administrimit mbledhet periodikisht."
18. Në nenin 35, pika 6 ndryshon në: "6. Vendimet e Bordit të Administrimit, zbardhen nga sekretaria, nënshkruhen nga Kryetari dhe si rregull hyjnë në fuqi menjëherë. Bordi i Administrimit mund të përcaktojë në vendim kohën e hyrjes në fuqi të tij."
19. Në nenin 37, në pikën 2, togfjalëshi "dekretohet nga Presidenti i Republikës" zëvendësohet me foljen "zgjidhet".
20. Në nenin 38 pika 2 bëhen këto ndryshime:
- Shkronja a) ndryshon në : "Emëron Dekanët e Fakulteteve"
 - në shkronjat d) dhe e) fjala "shkollor" zëvendësohet me fjalën "akademik";
 - shkronja o) shfuqizohet
21. Në nenin 39 bëhen këto ndryshime:
- Në pikën 1 fjala "Udhëzimin", zëvendësohet me "Rregulloren"
 - Pika 4 shfuqizohet
 - Pika 5 ndryshon në: "5. Në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në rregulloret e brendshme të institucionit, Senati Akademik shkarkon Rektorin."
 - Pika 6 ndryshon në: "6. Me vendim të Senatit Akademik, Zv. Rektori zëvendëson rektorin e shkarkuar, për një afat deri në 6 muaj, me qëllim organizimin e zgjedhjeve në institucion."
22. Në nenin 40, pika 2, shkronja "ç" shfuqizohet.
23. Në nenin 42, pika 2, shkronja "j" shfuqizohet.
24. Në nenin 43 pika 1 ndryshon në: "1. Dekani emërohet nga Rektori në përputhje me dispozitat e këtij Statuti."
25. Në të gjithë seksionin XI, togfjalëshi "Drejtor i Qendrës Kërkimore Shkencore", zëvendësohet me togfjalëshin "Përgjegjës i Qendrës Kërkimore Shkencore".
26. Në nenin 47, pika 1 ndryshon në: "1. Përgjegjësi i Departamentit/Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore emërohet nga Dekani i fakultetit përkatës në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, pas miratimit të Rektorit."
27. Në nenin 54, shkronja "f" shfuqizohet;



28. Në nenin 55, shkronja h) ndryshon në:

"h) Procedurat për largimin e Administratorit të institucionit:

- *Administratori i institucionit largohet nga detyra kur:*
 - *Jep dorëheqjen;*
 - *Shkarkohet nga Bordi i Administrimit.*
- *Procedurat që ndiqen nga Bordi i Administrimit, për shkarkimin e Administratorit janë:*
 - *Bordi i Administrimit bën vlerësimin me shkrim të Administratorit;*
 - *Anëtarët e Bordit të Administrimit me shumicë votash votojnë shkarkimin e tij."*

29. Neni 64 shfuqizohet.

30. Në nenin 65, në pikën 4 togfjalëshi "nga 1 vit në 1.5" zëvendësohet me "1 vit ose 2 vite akademike"

31. Në nenin 69, në pikën 1 togfjalëshi "maturën shtetërore" zëvendësohet me togfjalëshin "me sukses ciklin e arsimit të mesëm"; fjala "konkurroje" zëvendësohet me "konkurojë".

32. Në nenin 71, pika 2 ndryshon në: "2. *Diplomat e lëshuara nga institucioni shoqërohen me suplementin e diplomës."*

33. Në nenin 73 bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1 togfjalëshi "të të gjitha cikleve" zëvendësohet me togfjalëshin "të të njëjtit cikël"
- pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: "1/1. *Transferimet lejohen vetëm në fillim të vitit akademik;*"
- Në pikën 5 togfjalëshi "në rregulloret mësimore" zëvendësohet me togfjalëshin "në rregulloren e njesisë bazë dhe të programit të studimit "

34. Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:

- pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: "1/1. *Transferimet lejohen vetëm në fillim të vitit akademik;*"
- Në pikën 5 togfjalëshi "në rregulloret mësimore" zëvendësohet me togfjalëshin "në rregulloren e njesisë bazë dhe të programit të studimit".

35. Në nenin 78, pika 1 ndryshon në: "1. *Kolegji lëshon diploma për ciklin e dytë të studimeve të shoqëruara me suplementet përkatëse sipas programeve të studimit në secilin prej fakulteteve."*

36. Në nenin 83, pika 5 ndryshon në: "5. *Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, Kolegji lëshon certifikatat përkatëse, të cilat regjistrohen në përputhje me ligjin."*

37. Në nenin 84, në pikën 2, shfuqizohet fjalia e fundit: "Ministria ka të drejtë të autorizojë Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", për kryerjen e këtij procesi, për raste të njësimi të diplomës nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin."



38. Në nenin 85 bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshohet në: "1. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm."
- Në pikën 2 fjala "Ekuivalentimi" zëvendësohet me "Njohja e krediteve", si dhe shtohet fjalia "Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, me qëllim vazhdimin e studimeve i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë."
- Në pikën 3 togfjalëshi "procedurat per ekuivalentim" zëvendësohet me "procedurat për njohjen e krediteve".

39. Në nenin 90, pika 3 ndryshon në: "3. Vlefshmëria e cdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet."

40. Në nenin 94, pika 1 ndryshon në; "1. Projektbuxheti i Kolegjit hartohet nga Administratori, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përbërëse, si dhe miratohet në Senatin Akademik. Me propozim të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit miraton buxhetin e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë".

41. Në nenin 97, në pikën 3 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

- Shfuqizohet pjesa e fjalisë "pranë Kolegjit Universitar 'Instituti Kanadez i Teknologjisë';
- Shtohet fjalia në fund: "Bëjnë përgjashtëm nga ky nen studentët e shkëlqyer."


42. Në nenin 99, në titullin dhe në gjithë përmbajtjen e nenit togfjalëshi "Qeveria Studentore" zëvendësohet me togfjalëshin "Këshilli Studentor".

43. Shtojca Nr.2 zëvendësohet me shtojcën me të njëjtën numër që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim i përcillet Senatit Akademik.


Anëtarët:

1. Prof. Assoc. Vasil Qano
2. Prof. Assoc. Shkëlzen Cakaj
3. Dr. Amel Kovačević
4. Phd. Snežana Hristova




Kryetari:

Prof. Dr. Elez Osmani



ORGANIGRAMA E KOLEGJIT UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"



- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësise
- Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin
- Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore
- Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore
- Këshilli Etikës
- Këshilli Studentor

Shtojca Nr. 2 ndryshuar me:

- Vendim Bordi Administrimit nr.02, datë 30.03.2023, Vendim Senati Nr. 05, datë 30.03.2023, miratuar me Urdhër MAS nr.290, datë 07.06.2023
- Vendim Bordi i Administrimit nr. 8 datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik Nr. __, datë __, __, 2025, miratuar me Urdhër MAS _____



KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"
University College "Canadian Institute of Technology"

Licencuar me VKM nr.781, datë 10.11.2011
Akredituar me Urdhrin nr. 06, datë 27.01.2023
Zyra e Rektorit / Rector Office
rectoroffice@cit.edu.al
tel. 0674042042

Nr. 498 Prot.

Tiranë më, 4.11.2025

SENATI AKADEMIK

VENDIM

QARKULLUES

Nr. 10, datë 04.11.2025

"Mbi disa shtesa dhe ndryshime të propozuara në Statutin e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", të ndryshuar.

Në bazë të nenit 33/2 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në përmbushje të rekomandimeve të nëngrupit të punës të ngritur nga MAS për verifikimin e ligjshmërisë të veprimtarisë së IAL-ve..., në vijim të rekomandimeve të MAS, dërguar me shkresën Nr. 4930 Prot, datë 01.08.2025 dhe shkresën Nr. 4930/2 Prot, datë 15.10.2025, bazuar në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, Senati Akademik:

VENDOSI:

Në Statutin e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 1, pika 5 ndryshon në "5. Kolegji Universitar 'Instituti Kanadez i Teknologjisë', i nënshtrohet akreditimit periodik institucional dhe programeve të studimit sipas legjisllacionit për arsimin e lartë";
2. Në nenin 2, pika 2, shkronja b) ndryshon në "b) për të përfituar fonde nga pronari, shteti, organizata të tjera si dhe donacione";
3. Në nenin 3, fjalia e fundit ndryshon në "Selia e institucionit është e vendosur në Rr. 'Xhanfize Keko', Tiranë";
4. Në nenin 7 shtohet në fund paragrafi me këtë përmbajtje: "Kolegji Universitar 'Instituti Kanadez i Teknologjisë' ka të drejtë të krijojë në strukturën e tij autoritete dhe organe të tjera në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e tij.";
5. Neni 8 ndryshon në:



"Neni 8

Organet Drejtuese, Autoritetet Drejtuese, si dhe organe të tjera

1. Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" organi më i lartë drejtues akademik është:
 - a) Senati Akademik;
 2. Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" organet kolegjiale janë:
 - a) Rektorati;
 - b) Këshilli i Fakultetit;
 - c) Dekanatet;
 - d) Këshilli i Etikës.
 3. Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" organe të tjera akademike janë:
 - a) Asambletë e personelit akademik të njësive kryesore;
 - b) Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin;
 - c) Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore;
 - d) Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore;
 - e) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
 4. Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", autoritetet drejtuese akademike janë:
 - a) Rektori;
 - b) Dekanët;
 - c) Përgjegjësit e Departamenteve;
 - d) Përgjegjësit e Qendrave Kërkimore- Shkencore.
 5. Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" organi më i lartë administrativ është:
 - a) Bordi i Administrimit.
 6. Në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" autoritetet drejtuese administrative janë:
 - a) Administratori i Kolegjit;
 - b) Administratorët e Njësive Kryesore."
6. Në nenin 9, në pikën 2 bëhen këto ndryshime:
- Në shkronjën e), folja "miraton" zëvendësohet me foljen "harton";
 - Pas shkronjës m) shtohet shkronja m/1) me përmbajtje: "m/1) zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit";
7. Në nenin 10, në pikën 1 fjala "Udhëzimin' zëvendësohet me fjalën "Rregulloren".
8. Në nenin 11 shtohet pika "7" me këtë përmbajtje: "7. Mandati i anëtarit të ri është plotësues."
9. Në nenin 16 në pikën 1 shfuqizohet fjala "ekzekutiv".
10. Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:
- Përpara paragrafi 1 shtohet paragrafi: "Asambleja e personelit akademik përbëhet nga



personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore përkatëse.”;

- Në paragrafin 1, shkronja a) ndryshon në: “
 - a) zgjedh përfaqësuesit e njësisë kryesore (Fakultetit) përkatëse si anëtarë të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve në Rregulloren për zgjedhjet”;
 - shkronja b) ndryshon në: “Anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore në institucionet e arsimit të lartë vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësive kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhje.”
 - shkronja c) shfuqizohet

11. Në nenin 26 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: “1/1. Anëtarët e Këshillit të Fakultetit vetëkandidohen/propozohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhje.”

- Pika 3 ndryshon në: “3. Këshilli i Fakultetit drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga trupa akademike me kohë të plotë të njësisë kryesore. Këshilli përbëhet nga jo më shumë se 7 anëtarë, prej të cilëve 2 janë drejtues të njësive bazë dhe një prej tyre është përfaqësues i studentëve të njësisë kryesore.”

12. Pas nenit 27, shohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

Qendrat për zhvillim, inovacion dhe trajnime profesionale

1. Pranë Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” krijohen qendra për zhvillim, inovacion dhe trajnime profesionale, të cilat funksionojnë si struktura ndihmëse në varësi të Administratorit.

2. Qendrat e krijuara janë:

a) **Qendra për Siguri Kibernetike dhe Inteligjencë Artificiale (CCA1);**

b) **CIT HUB – Qendër për Start-Upe dhe Laborator Inovacioni;**

c) **Qendra për Zhvillim dhe Trajnim të Avancuar në Shqipëri (C-DATA).**

3. Këto qendra kanë për qëllim:

a) të ofrojnë trajnime profesionale, kurse të specializuara dhe shërbime praktike për studentë dhe publikun;

b) të nxisin zhvillimin teknologjik, inovacionin dhe sipërmarrjen studentore;

c) të realizojnë bashkëpunime me institucione dhe partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fusha të interesit.

4. Organizimi i brendshëm, drejtimi, mënyra e financimit dhe raportimit të tyre përcaktohen në rregullore të veçanta, të miratuara nga Senati Akademik.”

13. Në nenin 28 bëhen këto ndryshime:

- pika 2 ndryshon në: “2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjial. Ajo përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore (një për secilën njësi); 1(një) personel i administratës, 1 (një) përfaqësues nga studentët që propozohet nga Këshilli Studentor, dhe 1 (një) ekspert i sigurisë së cilësisë, minimalisht me dy vite eksperiencë, që drejton njësinë. Anëtarët e Njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.”

- Në pikën 3 fjala ‘I jashtëm’ pas fjalës ‘eksperti’ shfuqizohet

14. Në nenin 30, në pikën 2 pas shkronjës gj) shtohen shkronjat me përmbajtjen e mëposhtme:
“h) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikeqyr zbatimin e tij;

i) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të



- institucionit dhe mbikqyr zbatimin e tyre;*
- j) *vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit me një institucion tjetër;*
- k) *miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njërive përbërëse të institucionit."*
15. Në nenin 31, pika 1, fjalia e parë ndryshon në: "Bordi i Administrimit përbëhet nga pesë (5) anëtarë."
16. Në nenin 32 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje: "6. Mandati i anëtarit të ri është plotësues."
17. Në nenin 34, pika 1 ndryshon në: "1. Bordi i administrimit mbledhet periodikisht."
18. Në nenin 35, pika 6 ndryshon në: "6. Vendimet e Bordit të Administrimit, zbardhen nga sekretaria, nënshkruhen nga Kryetari dhe si rregull hyjnë në fuqi menjëherë. Bordi i Administrimit mund të përcaktojë në vendim kohën e hyrjes në fuqi të tij."
19. Në nenin 37, në pikën 2, togfjalëshi "dekretohet nga Presidenti i Republikës" zëvendësohet me foljen "zgjidhet".
20. Në nenin 38 pika 2 bëhen këto ndryshime:
- Shkronja a) ndryshon në : "Emëron Dekanët e Fakulteteve";
 - në shkronjat d) dhe e) fjala "shkollor" zëvendësohet me fjalën "akademik";
 - shkronja o) shfuqizohet
21. Në nenin 39 bëhen këto ndryshime:
- Në pikën 1 fjala "Udhëzimin", zëvendësohet me "Rregulloren"
 - Pika 4 shfuqizohet
 - Pika 5 ndryshon në: "5. Në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në rregulloret e brendshme të institucionit, Senati Akademik shkarkon Rektoren."
 - Pika 6 ndryshon në: "6. Me vendim të Senatit Akademik, Zv. Rektori zëvendëson rektorin e shkarkuar, për një afat deri në 6 muaj, me qëllim organizimin e zgjedhjeve në institucion."
22. Në nenin 40, pika 2, shkronja "ç" shfuqizohet.
23. Në nenin 42, pika 2, shkronja "j" shfuqizohet.
24. Në nenin 43 pika 1 ndryshon në: "1. Dekani emërohet nga Rektori në përputhje me dispozitat e këtij Statuti."
25. Në të gjithë seksionin XI, togfjalëshi "Drejtor i Qendrës Kërkimore Shkencore", zëvendësohet me togfjalëshin "Përgjegjës i Qendrës Kërkimore Shkencore".
26. Në nenin 47, pika 1 ndryshon në: "1. Përgjegjësi i Departamentit/Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore emërohet nga Dekani i fakultetit përkatës në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, pas miratimit të Rektorit."



27. Në nenin 54, shkronja "P" shfuqizohet;

28. Në nenin 55, shkronja h) ndryshon në:

h) Procedurat për largimin e Administratorit të institucionit:

- Administratori i institucionit largohet nga detyra kur:

- Jep dorëheqjen;
- Shkarkohet nga Bordi i Administrimit.

- Procedurat që ndiqen nga Bordi i Administrimit, për shkarkimin e Administratorit janë:

- Bordi i Administrimit bën vlerësimin me shkrim të Administratorit;
- Anëtarët e Bordit të Administrimit me shumicë votash votojnë shkarkimin e tij."

29. Neni 64 shfuqizohet.

30. Në nenin 65, në pikën 4 togfjalëshi "nga 1 vit në 1.5" zëvendësohet me "1 vit ose 2 vite akademike"

31. Në nenin 69, në pikën 1 togfjalëshi "maturën shtetërore" zëvendësohet me togfjalëshin "me sukses ciklin e arsimit të mesëm"; fjala "konkurroje" zëvendësohet me "konkurojë".

32. Në nenin 71, pika 2 ndryshon në: "2. Diplomat e lëshuara nga institucioni shoqërohen me suplementin e diplomës."

33. Në nenin 73 bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1 togfjalëshi "të të gjitha cikleve" zëvendësohet me togfjalëshin "të të njëjtit cikël"
- pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: "1/1. Transferimet lejohen vetëm në fillim të vitit akademik;"
- Në pikën 5 togfjalëshi "në rregulloret mësimore" zëvendësohet me togfjalëshin "në rregulloren e njësisë bazë dhe të programit të studimit"

34. Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:

- pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: "1/1. Transferimet lejohen vetëm në fillim të vitit akademik;"
- Në pikën 5 togfjalëshi "në rregulloret mësimore" zëvendësohet me togfjalëshin "në rregulloren e njësisë bazë dhe të programit të studimit".

35. Në nenin 78, pika 1 ndryshon në: "1. Kolegji lëshon diploma për ciklin e dytë të studimeve të shoqëruara me suplementet përkatëse sipas programeve të studimit në secilin prej fakulteteve."

36. Në nenin 83, pika 5 ndryshon në: "5. Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, Kolegji lëshon certifikatat përkatëse, të cilat regjistrohen në përputhje me ligjin."



37. Në nenin 84, në pikën 2, shfuqizohet fjalia e fundit: "Ministria ka të drejtë të autorizojë Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", për kryerjen e këtij procesi, për raste të njësimi të diplomës nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin."

38. Në nenin 85 bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshohet në: "1. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja njmen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm."
- Në pikën 2 fjala "Ekuivalentimi" zëvendësohet me "Njohja e krediteve", si dhe shtohet fjalia "Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, me qëllim vazhdimin e studimeve i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë."
- Në pikën 3 togfjalëshi "procedurat per ekuivalentim" zëvendësohet me "procedurat për njohjen e krediteve".

39. Në nenin 90, pika 3 ndryshon në: "3. Vlefshmëria e cdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet."

40. Në nenin 94, pika 1 ndryshon në; "1. Projektbuxheti i Kolegjit hartohet nga Administratori, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përbërëse, si dhe miratohet në Senatin Akademik. Me propozim të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit miraton buxhetin e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë".

41. Në nenin 97, në pikën 3 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

- Shfuqizohet pjesa e fjalisë "pranë Kolegjit Universitar 'Instituti Kanadez i Teknologjisë'";
- Shtohet fjalia në fund: "Bëjnë përjashtim nga ky nen studentët e shkëlqyer."

42. Në nenin 99, në titullin dhe në gjithë përmbajtjen e nenit togfjalëshi "Qeveria Studentore" zëvendësohet me togfjalëshin "Këshilli Studentor".

43. Shtojca Nr.2 zëvendësohet me shtojcën me të njëjtën numër që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim përcillet për miratim pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Miratuar unanimisht nga anëtarët e Senatit

Pjesëmarrësit në mbledhje:

Prof. Dr. Ismail Kocayusufoglu

Prof. Asoc. Nihat Adar



Prof. Asoc. Dr. Entelë Gavoçi

Prof. Asoc. Manjola Naço

Dr. Enriko Ceko

Dr. Wassim Ahmad

Dr. Eugen Musta

Dr. Alfons Harizaj

Megi Meta (stud.)



(shpallur vakanca)

(shpallur vakanca)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR
“INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

STATUTI
I
KOLEGJI UNIVERSITAR
“INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”



Miratuar me Vendim nr. 69, datë 21.09.2016, të Senatit Akademik të “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Tiranë 2016

Ndryshuar me:

- *Vendim Bordi Administrimi nr.02, datë 30.03.2023, Vendim Senati Nr. 05, datë 30.03.2023, miratuar me Urdhër MAS nr.290, datë 07.06.2023*
- *Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025*



(i përditësuar)

PJESA E PARË
KREU I
PARIME THEMELORE

Neni 1

Kolegji Universitar “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

(ndryshuar pika 5 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA. nr.619, datë 24.12.2025)

1. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, është themeluar nga shoqëria “C.I.T” sh.p.k, regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë, pajisur me NIPT Nr. L11614010R, të pasqyruar në certifikatën e regjistrimit.
2. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, është vijimi i Shkollës së Lartë Universitare Private "Instituti Kanadez i Teknologjisë", si dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe VKM, Nr. 781, Datë 10.11.2011 “Për Licencimin e Shkollës së lartë universitare private "Instituti Kanadez i Teknologjisë",
3. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, është person juridik fitimprurës.
4. Kolegji në funksionimin e tij bazohet edhe në legjislacionin tregtar dhe ky Statut rregullon veprimtarinë e institucionit.
5. *Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, i nënshtrohet akreditimit periodik institucional dhe programeve të studimit sipas legjislacionit për arsimin e lartë”.*

Neni 2

Autonomia e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

(ndryshuar shkronja “b)”, pika 2, me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, gëzon liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit.

1. Liria akademike garantohet nëpërmjet të drejtës:

- a) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato të kërkimit shkencor si edhe veprimtaritë krijuese;
- b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e kërkimit shkencor;
- c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.

2. Autonomia financiare garantohet nëpërmjet të drejtës:

- a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaria e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga shërbimet etj;

*Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të Kolegjit Kanadez i Teknologjisë
Tiranë 2016, I ndryshuar*



- b) për të përfiturar fonde nga pronari, shteti, organizata të tjera si dhe donacione;
- c) për të caktuar rregulla të brendshme të financimit e të përdorimit të të ardhurave;
- d) për të përcaktuar tarifat e studimit;
- e) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që disponon, në funksion të realizimit të misionit të tij, etj.

3. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet të drejtës:

- a) për t'u vetëqeverisur, për të përzgjedhur organizmat drejtuese, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të brendshme (Statutit dhe rregulloreve të Kolegjit), të hartuara në përputhje me Ligjin dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;
- b) për të përcaktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit në përputhje me Ligjin dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për veprimtari mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese etj.;
- d) për të caktuar në mënyrë të pavarur pagat e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij.

4. Veprimtaria e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë.

5. Shteti garanton paprekshmërinë e Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" dhe të territorit të tij.

6. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me kërkesën ose lejen e titullarit të Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë". Vetëm në rastet e kryerjes së një vepre penale flagrante, në rastet e fatkeqësive natyrore dhe gjendjes së jashtëzakonshme, organet e rendit publik kanë të drejtë të ndërhyjnë edhe pa lejen e titullarit.

Neni 3

Emri, stema dhe selia

(ndryshuar fjalia e fundit me Vendim Bordin Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

Institucioni do të njihet me emrin Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë". Institucioni ka stemën e tij dalluese ku shkruhet CIT me gërma të mëdha dhe shkrimi në gjuhën angleze "Canadian Institute of Technology".

Stema i bashkëlidhet këtij statuti si *Shtojca 1* dhe është pjesë përbërëse e tij.

Selia e institucionit është e vendosur në Rr. "Xhanfize Keko", Tiranë.



Neni 4

Vizioni dhe Misioni i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

Vizioni

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është i vendosur që të përgatisë studentë me aftësi të mbështetura mbi edukimin, vlerat dhe shpirtin etik, mendimin kritik, atë analitik dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve, kreativitetit, inovacionit dhe lidhshimit, të cilat ata do t’i përdorin për t’i dhënë formë jetës, karrierës dhe shoqërisë.

Misioni

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” përmes promovimit të kurrikulave të përgatitura me kujdes, mësimdhënies, kërkimit shkencor, hapjes së programeve të reja, ka si mision zhvillimin e aftësive personale dhe mundësive, nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat e Shqipërisë.

Kolegji Universitar e shpreh angazhimin e tij drejt këtij misioni sipas qëllimeve të përcaktuara më poshtë:

- a) Ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.
- b) Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;
- c) Formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit, në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.
- d) Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.
- e) Kryerjen e studimeve kërkimore - shkencore për të zhvilluar e tejçuar aplikime dhe inovacione në fushat e kërkimeve të inxhinierisë dhe të ekonomisë.
- f) Të ofrojë mundësit më të mira për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- g) Të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.

Neni 5

Detyrimet e Kolegjit

Duke gëzuar liri akademike dhe autonomi, sipas Ligjit, Kolegji angazhohet të përmbushë të gjitha detyrimet që burojnë nga Ligji, aktet nënligjore me të gjitha palët dhe në të gjitha marrëdhëniet e

ligjshme. Më konkretisht, detyrohet të përmbushë, por duke mos u kufizuar vetëm në detyrimet e mëposhtme:

- a) të zhvillojë procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore - shkencore sipas programeve mësimore të hapura pranë saj me qëllim që të përgatisë specialistë të lartë në nivelin e kërkesave të kohës në fushat respektive;
- b) të përballojë me shpenzimet e veta, procesin mësimor dhe kërkimin shkencor;
- c) të kryejë brenda afateve të përcaktuara në ligj, në bashkëpunim me ASCAL, procesin e vlerësimit dhe akreditimit, i cili duhet të bëhet i njohur për publikun;
- d) të paraqesë në MAS:
 - i) raportin e veprimtarisë mësimore në çdo fund viti akademik;
 - ii) njoftimin për veprimtarinë kërkimore - shkencore në çdo fund viti kalendarik;
 - iii) listën e personelit akademik në çdo fillim viti akademik ose çdo semestër.
- e) të bëjë publike kriteret e pranimit të studentëve në të gjitha programet e studimit dhe ciklet.

Neni 6

Pasuria në pronësi dhe paprekshmëria e Kolegjit

1. Kolegji e zhvillon veprimtarinë e tij në mjediset dhe me mjetet e vëna në dispozicion nga shoqëria "C.I.T" sh.p.k. Të gjitha mjediset e Kolegjit, gëzojnë paprekshmëri në kuptimin e Ligjit. Mjediset e Kolegjit nuk lejohet të preken apo çënohen nga të tretët. Paprekshmëria përfshin moslejimin e ndërhyrjes në to apo të përdorimit të tyre nga çdo person tjetër fizik e juridik.
2. Për çdo cënim të paprekshmërisë, Kolegjit i lind e drejta e denoncimit të shkeljes dhe kërkimit të ndëshkimit të shkelësit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 7

Organigrama - përbërja strukturore e institucionit

(shtuar paragrafi fundit me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

Organigrama e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", me njësitë përbërëse të saj, që shpreh lidhjet dhe varësitë ndërmjet tyre, është miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

Përbërja strukturore dhe organizative e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", përbëhet nga:

- a) Pjesa akademike, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese akademike, njësitë kryesore (fakultetet), njësitë bazë (departamentet) dhe qendrat kërkimore shkencore.
- b) Pjesa administrative, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese administrative dhe njësitë e shërbimit.

Përbërja strukturore dhe organizative e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, është sipas *Shtojcës 2*, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij Statuti.

Kolegji Universitar ‘Instituti Kanadez i Teknologjisë’ ka të drejtë të krijojë në strukturën e tij autoritete dhe organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e tij.

PJESA E DYTË

ORGANET DHE AUTORITETET DREJTUESE

Neni 8

Organet Drejtuese, Autoritetet Drejtuese, si dhe organe të tjera

(ndryshuar me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

- 1. Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, organi më i lartë drejtues akademik është:**
 - a) Senati Akademik;
- 2. Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” organet kolegjiale janë:**
 - a) Rektori;
 - b) Këshilli i Fakultetit;
 - c) Dekanatet;
 - d) Këshilli I Etikës.
- 3. Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” organe të tjera akademike janë:**
 - a) Asambletë e personelit akademik të njëjësive kryesore;
 - b) Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin;
 - c) Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore;
 - d) Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore;
 - e) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
- 4. Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, autoritetet drejtuese akademike janë:**
 - a) Rektori;
 - b) Dekanët;
 - c) Përgjegjësit e Departamenteve;
 - d) Përgjegjësit e Qendrave Kërkimore- Shkencore.
- 5. Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” organi më i lartë administrativ është:**

a) *Bordi i Administrimit.*

6. Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” autoritetet drejtuese administrative janë:

a) *Administratori i Kolegjit;*

b) *Administratorët e Njësive Kryesore*

Seksioni I

SENATI AKADEMIK I KOLEGJIT

Neni 9

Senati Akademik

(-ndryshuar shkronja e) pika 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025; -shtuar shkronja m/1, pika 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

- 1) Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati Akademik kryesohet nga Rektori dhe mbledhet periodikisht, sipas përcaktimeve në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të senatit.
- 2) Funksionet kryesore të Senatit Akademik janë:
 - a) garanton autonominë e institucionit, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
 - b) i propozon Bordit të Administrimit Planin Strategjik të Zhvillimit të Institucionit dhe miraton programin vjetor të veprimtarive të tij;
 - c) miraton Statutin e institucionit, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit. Statuti i miratuar dërgohet në ministrinë përgjegjëse për arsimin, për miratim përfundimtar nga ministri;
 - d) zgjedh Rektoren e Kolegjit;
 - e) harton strukturën akademike të institucionit, sipas kërkesave të Ligjit, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
 - f) miraton Rregulloren e institucionit, rregulloret e njësive përbërëse të tij, rregulloret e programeve të studimit, si dhe rregulloret dhe aktet e tjera që janë kompetencë e Senatit;
 - g) miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet në këto programe si edhe mbylljen e tyre. Programet e reja miratohen pasi të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
 - h) propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit si dhe bashkimin me një institucion tjetër të arsimit të lartë, pasi është marrë mendimi i Bordit të Administrimit;

- i) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njërive kryesore ose bazë, mbi bazën e propozimeve të njërive kryesore dhe të njërive bazë, duke marrë vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
- j) miraton ndryshimin e emrit ose stemës së institucionit, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- k) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
- l) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga Rektori, dhe ia përcjell ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- m) vlerëson dhe garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion. Anëtarët e kësaj njësie miratohen nga Senati, me propozimin e Rektorit;
- m/1) zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;
- n) në fund të çdo viti akademik organizon një mbledhje të përbashkët të Senatit Akademik me Bordin e Administrimit, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare e administrative të institucionit.

Neni 10

Përbërja e Senatit Akademik

(ndryshuar pika 1 me Vendim Bordin Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Anëtarët e Senatit Akademik, zgjidhen drejtpërdrejtë nga asambljetë e personelit akademik me kohë të plotë të njërive kryesore, në përputhje me ligjin dhe sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Organizimin dhe Zhvillimin e Zgjedhjeve në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
2. Senati Akademik i Kolegjit përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë. Anëtarët e Senatit Akademik për efekt të zgjedhjes, janë të ndarë si më poshtë:
 - a. Rektori i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”;
 - b. Zv.Rektori
 - c. Dy Dekanët (i Fakultetit të Ekonomisë dhe i Fakultetit të Inxhinierisë)
 - d. Përfaqësuesit e fakulteteve, nga dy për çdo fakultet;
 - e. Përfaqësuesi i studentëve.
3. Anëtarët e Senatit i përkasin kategorisë “Profesor” ose mbajnë gradën shkencore “Doktor” (“PhD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbrisë në gradën "Doktor" dhe "MSc", me përjashtim të përfaqësuesit të studentëve.

Neni 11

Mandati i Senatit Akademik dhe i anëtarëve të tij

(shtuar pika 7 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Senati Akademik si organ kolegjal ka mandat 4 vjeçar.
2. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik fillon nga momenti i zgjedhjes dhe zgjat deri në përfundim të mandatit të Senatit Akademik.
3. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik konsiderohet i përfunduar në mënyrë të parakohshme në rastet kur anëtari:
 - a) Jep dorëheqjen si anëtar i Senatit Akademik;
 - b) Në rastet kur shkarkohet, lirohet apo jep dorëheqjen nga detyra.
 - c) Përfundon marrëdhënien e punës me Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, apo përfundon/ndërpret studimet në Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
 - d) Ndërron jetë;
 - e) Nuk merr pjesë në më shumë se gjysmën e mbledhjeve të zhvilluara gjatë një viti akademik;
 - f) Dënohet për një vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
4. Senati Akademik konstaton vakancën e krijuar me anë të një vendimi deklarativ.
5. Vendi vakant i krijuar nga përfundimi në mënyrë të parakohshme i mandatit të një anëtari të Senatit Akademik, plotësohet me një person tjetër të zgjedhur nga i njëjti grup i anëtarëve të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
6. Zgjedhjet për plotësimin e vendit vakant në Senatit Akademik zhvillohen brenda 6 muajve nga data e vendimit për konstatimin e vakancës.
7. *Mandati i anëtarit të ri është plotësues.*

Neni 12

Mbledhja e parë e senatit akademik

1. Në mbledhjen e tij të parë, Senati Akademik thirret nga Rektori i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
2. Në këtë mbledhje zgjidhet nënkryetari i Senatit Akademik, nga radhët e anëtarëve dhe sekretariati i Senatit. Zgjedhja e nënkryetarit bëhet edhe në rastet e mbarimit të mandatit në mënyrë të parakohshme të anëtarit të zgjedhur nënkryetar, apo kur nënkryetari jep dorëheqjen nga kjo detyrë.
3. Nënkryetari propozohet nga Kryetari i Senatit Akademik dhe zgjidhet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Senatit.

4. Në mbledhjen e tij të parë Senati Akademik miraton propozimet e Rektorit për pozicionin e Zëvendësrektorit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
5. Në mbledhjen e tij të parë Senati Akademik propozon komisionet e përhershme si më poshtë:
 - a. Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin;
 - b. Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore;
 - c. Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore;
6. Përbërja, të drejtat, detyrat dhe funksionimi i komisioneve të përhershme, përcaktohen nga Senati Akademik në Rregulloren e komisioneve të përhershme.
7. Senati Akademik ngre Këshillin e Etikës, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Statut dhe rregulloren e Këshillit të Etikës.

Neni 13

Thirrja e mbledhjes së Senatit Akademik

1. Senati Akademik si rregull mbledhet të paktën një herë në muaj. Senati Akademik mund të miratojë rregulla shtesë, të cilat mund të përcaktojnë mbledhjen në një datë dhe orë të njëjtë, për çdo muaj.
2. Mbledhja e Senatit Akademik thirret nga:
 - a. Rektori (Kryetari i Senatit);
 - b. Nga anëtarë të Senatit të cilët përbëjnë të paktën një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
3. Mbledhja thirret nëpërmjet njoftimit me shkrim ose postë elektronike, të paktën 7 ditë përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes. Së bashku me njoftimin për rendin e ditës, thirrësit e mbledhjes shpërndajnë edhe materialet mbi çështjet që do të shqyrtohen në mbledhje. Njoftimi i rendit të ditës dhe i materialeve bëhet me protokoll ose me postë elektronike, në përputhje me Rregulloren e brendshme për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit.

Neni 14

Vlefshmëria e mbledhjes dhe e vendimeve të Senatit Akademik

1. Mbledhjet e Senatit Akademik drejtohen nga Kryetari. Nënkyetari i Senatit Akademik drejton mbledhjet e Senatit në rast të mungesës së Kryetarit.
2. Mbledhjet e Senatit Akademik janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Në rast se në mbledhje janë të pranishëm më pak se 2/3 e anëtarëve, atëherë mbledhja nuk zhvillohet dhe shtyhet për një datë tjetër, por jo më vonë se tetë ditë nga data e paracaktuar.



3. Anëtarët e Senatit Akademik e ushtrojnë vetë funksionin e tyre. Ata nuk mund t'ia delegojnë votën një anëtar tjetër dhe as të votojnë në emër të një anëtar tjetër të Senatit.
4. Votimi në Senatin Akademik si rregull është i hapur. Në rastet kur vendimi për të cilin do të votohet i referohet personave të përveçëm, Senati mund të vendosë me shumicë të thjeshtë për të zhvilluar votim të fshehtë, në rast se kjo kërkohet nga secili prej anëtarëve. Procedurat për zhvillimin e votimit të fshehtë përcaktohen nga Senati Akademik.
5. Senati merr vendime me shumicë të thjeshtë, me përjashtim të rasteve kur për marrjen e vendimeve kërkohet një shumicë e cilësuar, sipas përcaktimeve në këtë Statut.
6. Vendimet e Senatit Akademik, si rregull hyjnë në fuqi menjëherë. Senati Akademik mund të përcaktojë në vendim, kohën e hyrjes në fuqi të tij.
7. Në mbledhjen e Senatit Akademik, mund të thirren administratorët (i institucionit ose të njësisë kryesore, veçmas ose bashkërisht) dhe specialistë të fushave të ndryshme, që kanë dijeni mbi çështjet të cilat janë shtruar për diskutim. Specialistët mund të jenë të brendshëm apo të jashtëm.
8. Senati Akademik, me ndihmën e Rektoratit cakton sekretarinë teknike, si një strukturë *ad hoc*, e cila përbëhet nga të paktën një person për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.
9. Pjesë e sekretarisë teknike do të konsiderohen edhe persona të tjerë, punonjës të administratës të cilët japin shpjegime gjatë mbledhjes së Senatit, lidhur me materialet e paraqitura dhe çështjet që diskutohen.

Neni 15

Zbardhja, nënshkrimi dhe publikimi i vendimeve të Senatit Akademik

1. Vendimet e marra nga Senati Akademik zbardhen brenda ditës së nesërme të mbledhjes në të cilën vendimi është miratuar.
2. Vendimet e senatit akademik zbardhen dhe nënshkruhen nga Kryetari i Senatit dhe të gjithë anëtarë, ndërsa procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i këtij organi akademik.
3. Vendimet e Senatit Akademik publikohen në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit.
4. Për sa është e mundur, vendimet e Senatit Akademik publikohen në faqen e internetit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Seksioni II

REKTORATI I KOLEGJIT



Neni 16

Përbërja e Rektoratit të Kolegjit

(shfuqizuar fjala “ekzekutiv” pas togfjalëshit “organ kolegjal”, në pikën 1, me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Rektorati i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, është organ kolegjal.
2. Rektorati përbëhet nga:
 - a. Rektori;
 - b. Zëvendësrektori;
 - c. Dekani i Fakultetit të Ekonomisë;
 - d. Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë;
 - e. Administratori i Kolegjit.
3. Rektorati thirret në mbledhjen e parë nga Rektori dhe në vijim, për çdo mbledhje nga Rektori ose nga të paktën dy prej anëtarëve.

Neni 17

Funksionet dhe detyrat e tjera të Rektoratit

Funksionet e Rektoratit janë si më poshtë:

- a) harton planin disavjeçar të zhvillimit të Kolegjit;
- b) harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik;
- c) propozon kriteret për shpërndarjen e burimeve materiale dhe njerëzore akademike;
- d) harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim në Senatin Akademik;
- e) propozon planin për investime, kontrata dhe marrëveshje, që janë kompetencë e tij;
- f) paraqet rekomandime për projektet, programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
- g) zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik;
- h) monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Neni 18

Mbledhjet dhe vendimmarrja e Rektoratit

1. Rektorati mblidhet si rregull jo më pak se një herë në dy javë. Në raste të nevojshme Rektorati mund të mblidhet në çdo kohë, me kusht që të lihet kohë e mjaftueshme për shqyrtimin e materialeve që lidhen me çështjet për diskutim.

2. Mbledhja konsiderohet e vlefshme nëse marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
3. Mbledhja nuk mund të zhvillohet dhe duhet të shtyhet, në rastet kur edhe pse është plotësuar numri i anëtarëve të nevojshëm, nuk është prezent anëtari, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen për të cilën do të merret vendim.
4. Si rregull Rektorati merr vendime njëzëri. Kur kjo nuk është e mundur, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur nuk mund të arrihet shumica, vota e Rektorit është përcaktuese.
5. Procesverbali i mbajtur në mbledhjen e Rektoratit përbën dokumentin bazë për pasqyrimin e vendimmarrjes.
6. Vendimet e marra nga Rektorati, materializohen në formën e urdhrave të nxjerra nga Rektori i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Seksioni III

DEKANATET E KOLEGJIT

Neni 19

Përbërja e dekanateve të kolegjit

1. Dekanatet e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, janë organe kolegjinale ekzekutive të njësive kryesore përkatëse.
2. Dekanati përbëhet nga:
 - a. dekani;
 - b) zëvendësdekani;
 - c) administratori i njësisë kryesore;
 - d) drejtuesit e njësive bazë
3. Dekanati thirret në mbledhjen e parë nga Dekani.

Neni 20

Funksionet dhe detyrat e tjera të Dekanatit

Funksionet e dekanatit janë si më poshtë:

- a) harton planin disavjeçar të zhvillimit të njësisë kryesore;
- b) harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Rektorat dhe Senat;
- c) propozon kriteret për shpërndarjen e burimeve materiale dhe njerëzore akademike të njësisë kryesore;
- d) harton dhe propozon projektbuxhetin për njësinë kryesore;
- e) paraqet rekomandime për projektet, programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;



- f) zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik;
- g) zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Këshilli i Fakultetit.

Neni 21

Mbledhjet dhe vendimmarrja e Dekanatit

1. Dekanati mbledhet si rregull jo më pak se një herë në muaj. Në raste të nevojshme Dekanati mund të mbledhet në çdo kohë, me kusht që të lihet kohë e mjaftueshme për shqyrtimin e materialeve që lidhen me çështjet për diskutim.
2. Mbledhja thirret nga Dekani kryesisht, apo me kërkesën e secilit prej anëtarëve të Dekanatit.
3. Mbledhja konsiderohet e vlefshme nëse marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
4. Mbledhja nuk mund të zhvillohet dhe duhet të shtyhet, në rastet kur edhe pse është plotësuar numri i anëtarëve të nevojshëm, nuk është prezent anëtari, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen për të cilën do të merret vendim.
5. Si rregull dekanati merr vendime njëzëri. Kur kjo nuk është e mundur, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur nuk mund të arrihet shumica, vota e Dekanit është përcaktuese.
6. Proçesverballi i mbajtur në mbledhjen e Dekanatit përbën dokumentin bazë për pasqyrimin e vendimmarrjes.
7. Vendimet e marra nga Dekanati, materializohen në formën e urdhrave të nxjerra nga Dekani i njësisë kryesore.

Seksioni IV

ASAMBLETË E PERSONELIT AKADEMIK TË NJËSIVE KRYESORE

Neni 22

Asamblatë e personelit akademike të njësive kryesore

(-shtuar paragrafi me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;
-ndryshuar shkronja a), b) e paragrafi 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;
-shfuqizuar shkronja c) paragrafi 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr.10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore përkatëse.

1. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore (fakultetit përkatës) në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, ka këto funksione:

- a) *zgjedh përfaqësuesit e njësisë kryesore (Fakultetit) përkatëse si anëtarë të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve në Rregulloren për zgjedhjet;*
- b) *Anëtarët e komisioneve të përhershme të njësisë kryesore në institucionet e arsimit të lartë vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.;*
- c) *shfuqizuar.*

2. Asambletë e personelit akademik mund të ushtrojnë edhe kompetenca të tjera, sipas përcaktimeve në rregulloret e brendshme të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Seksioni V

KËSHILLI I ETIKËS

Neni 23

Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, ngrihet me Vendim të Senatit Akademik. Ky Këshill ka mandat 4 vjeçar. Këshilli i Etikës përbëhet nga 3-5 anëtarë, të përzgjedhur nga punonjësit akademikë të Kolegjit.
2. Këshilli i Etikës ka si funksion kryesor diskutimin e problemeve që lidhen me etikën e jetës universitare në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
3. Këshilli i Etikës merr vendime dhe i paraqet propozime Rektorit të Kolegjit.

Neni 24

Funksionimi i Këshillit të Etikës

1. Senati Akademik cakton Kryetarin e Këshillit të Etikës dhe anëtarët.
2. Këshilli i Etikës mblidhet sa herë që paraqitet një kërkesë për shqyrtim nga subjektet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.
3. Kërkesa që paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Etikës përmban të paktën të dhënat e kërkuarit, një përkthim të shkurtër të çështjes së shtruar për diskutim, si edhe materiale shoqëruese të cilat shërbejnë për shqyrtimin e çështjes.
4. Këshilli i Etikës merr në shqyrtim kërkesa të paraqitura nga:
 - a) Senati Akademik;

- b) Bordi i Administrimit;
- c) Rektori;
- d) Zëvendësrektori;
- e) Dekani (ët);
- f) Këshilli i Studentëve;
- g) Të paktën 2 anëtarë të personelit akademik të Kolegjit.

Neni 25

Kodi i Etikës

1. Kodi i Etikës diskutohet nga Këshilli i Etikës dhe më pas i kalon për miratim Senatit Akademik.
2. Rregulla më të detajuara mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës si dhe vendimmarrjet e këtij këshilli, përcaktohen në rregulloren e tij apo vet Kodin e Etikës.

Seksioni VI

KOMISIONET E PËRHERSHME

Neni 26

Këshilli i Fakultetit

(-shtuar pika 1/1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

- ndryshuar pika 3 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1.Këshilli i fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës akademik në kuadër të Fakultetit përkatës.

1/1. Anëtarët e Këshillit të Fakultetit vetëkandidohen/propozohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Këshilli i Fakultetit ka këto funksione:

- a) programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit;
- b) propozon programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor;
- c) propozon hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësish të tjera;
- d) shqyrton e miraton, në një mbledhje të hapur për personelin akademik dhe për studentët, raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore të fakultetit.
- e) ngre grupe pune në bazë të fushave të studimit, me fokus kërkimin shkencor apo organizimin e konferencave etj.
- f) shqyrton e miraton grupet mësimore lëndore dhe ndër-lëndore

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të 'Institutit Kanadez I Teknologji'

Tiranë 2016, I ndryshuar



3. Këshilli i Fakultetit drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga trupa akademike me kohë të plotë të njësisë kryesore. Këshilli përbëhet nga jo më shumë se 7 anëtarë, prej te cilëve 2 janë drejtues të njësisë bazë dhe një prej tyre është përfaqësues i studentëve të njësisë kryesore.
4. Vendimet i merr me shumicë të thjeshtë votash, të anëtarëve prezent në mbledhje.

Neni 27

Komisionet e tjera të përhershme

Komisionet e tjera të përhershme janë organe kolegjiale, që kryejnë funksione sipas përcaktimeve në aktin e ngritjes nga Senati Akademik dhe rregulloret e funksionimit të tyre.

Neni 27/1

Qendrat për zhvillim, inovacion dhe trajnime profesionale

(shtuar me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Pranë Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” krijohen qendra për zhvillim, inovacion dhe trajnime profesionale, të cilat funksionojnë si struktura ndihmëse në varësi të Administratorit.
2. Qendrat e krijuara janë:
 - a) Qendra për Siguri Kibernetike dhe Inteligjencë Artificiale (CCAI);
 - b) CIT HUB – Qendër për Start-Upe dhe Laborator Inovacioni;
 - c) Qendra për Zhvillim dhe Trajnim të Avancuar në Shqipëri (C-DATA).
3. Këto qendra kanë për qëllim:
 - a) të ofrojnë trajnime profesionale, kurse të specializuara dhe shërbime praktike për studentë dhe publikun;
 - b) të nxisin zhvillimin teknologjik, inovacionin dhe sipërmarrjen studentore;
 - c) të realizojnë bashkëpunime me institucione dhe partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fusha të interesit.
4. Organizimi i brendshëm, drejtimi, mënyra e financimit dhe raportimit të tyre përcaktohen në rregullore të veçanta, të miratuara nga Senati Akademik.

Seksioni VII

NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Neni 28

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

(-ndryshuar pika 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të ‘Institutit Kanadez I Teknologjisë’

Tiranë 2016, I ndryshuar



- Në pikën 3 fjala 'I jashtëm' pas fjalës 'eksperti' shfuqizohet me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", krijon Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, strukturë e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.
2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore (një për secilën njësi); 1 (një) personel i administratës, 1 (një) përfaqësues nga studentët që propozohet nga Këshilli Studentor, dhe 1 (një) ekspert i sigurisë së cilësisë, minimalisht me dy vite eksperiencë, që drejton njësinë. Anëtarët e Njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.
3. Kryetari i njësisë, që është dhe eksperti, propozohet nga rektori dhe miratohet në Senatin Akademik.

Neni 29

Kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë:

1. Të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik.
2. Të hartojë standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë.
3. Të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore -shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit në përputhje me standardet.
4. Të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji.
5. Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.
6. Pas çdo vlerësimi të raportojë para Senatit Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse.

Seksioni VIII

BORDI I ADMINISTRIMIT

Neni 30

Bordi i Administrimit

(-shtuar shkronja h), i), j), k) në pikën 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr.10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)



1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij.
2. Funksionet e Bordit të Administrimit të Kolegjit janë si më poshtë:
 - a) garanton qendrueshmërinë financiare të Institucionit dhe përmbushjen e misionit të tij;
 - b) jep mendim për projektregulloren e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” dhe miraton Rregulloren Financiare të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”;
 - c) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
 - d) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”;
 - e) emëron dhe shkarkon administratorin e Institucionit;
 - f) miraton paraprakisht Statutin e Institucionit, para se t’i përcillet Senatit Akademik;
 - g) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së Institucionit, të hartuar nga rektorati.
 - gj) miraton nivelin e pagave për të gjithë personelin e institucionit.
 - h) *me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;*
 - i) *me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;*
 - j) *vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit me një institucion tjetër;*
 - k) *miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit.*

Neni 31

Përbërja e Bordit të Administrimit

(-ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Bordi i Administrimit përbëhet nga pesë anëtarë. Anëtarët e përzgjedhur kanë mandat 4 vjeçar, me këtë përbërje:

a) 2 anëtarë nga stafi i institucionit që përzgjidhen nga Senati Akademik.

b) 3 anëtarë përzgjidhen dhe emërohen nga themeluesit e Kolegjit ose të autorizuar prej tyre.

2. Autoritetet drejtuese të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (rektori, administratori i Kolegjit, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë dhe administratorët e njësive kryesore) nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Administrimit. Autoritete drejtuese të



caktuara mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit të Administrimit, sipas problematikave për sektorët që mbulojnë.

Neni 32

Mandati i Bordit të Administrimit dhe i anëtarëve të tij

(shtuar pika 6 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Bordi i Administrimit si organ kolegjal ka mandat 4 vjeçar.
2. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit fillon nga momenti i zgjedhjes dhe zgjat deri në përfundim të mandatit të Bordit të Administrimit.
3. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit konsiderohet i përfunduar në mënyrë të parakohshme në rastet kur anëtari:
 - a. Jep dorëheqjen si anëtar i Bordit të Administrimit;
 - b. Përfundon marrëdhëniet e punës me Kolegjin;
 - c. Ndërron jetë;
 - ç. Nuk merr pjesë në më shumë se gjysmën e mbledhjeve të zhvilluara gjatë një viti akademik;
 - d. Dënohet për një vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë.
4. Bordi i Administrimit konstaton vakancën e krijuar me anë të një vendimi deklarativ.
5. Vendi vakant i krijuar nga përfundimi në mënyrë të parakohshme i mandatit të një anëtari të Bordit të Administrimit, plotësohet me një person tjetër nga i njëjti grup i anëtarit të larguar.
6. *Mandati i anëtarit të ri është plotësues.*

Neni 33

Mbledhja e parë e Bordit të Administrimit

1. Në mbledhjen e tij të parë, Bordi i Administrimit thirret nga Rektori i Kolegjit;
2. Në këtë mbledhje zgjidhet Kryetari i Bordit të Administrimit, nga radhët e anëtarëve të brendshëm të bordit, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të të bordit.
3. Zgjedhja e kryetarit bëhet edhe në rastet e mbarimit të mandatit në mënyrë të parakohshme të anëtarit të zgjedhur kryetar, apo kur kryetari jep dorëheqjen nga kjo detyrë.

Neni 34

Thirrja e mbledhjes së Bordit të Administrimit

(ndryshuar pika 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. *Bordi i administrimit mblidhet periodikisht.*



2. Mbledhja e Bordit, thirret nga kryetari i Bordit të Administrimit apo dy anëtarë të tij.
3. Mbledhja mund të thirret edhe me kërkesë të Rektorit ose të Administratorit të Kolegjit.
4. Mbledhja thirret nëpërmjet njoftimit me shkrim ose postë elektronike të rendit të ditës, të paktën 7 ditë përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes. Së bashku me njoftimin për rendin e ditës, thirrësit e mbledhjes njoftojnë/shpërndajnë edhe materialet mbi çështjet që do të shqyrtohen në mbledhje. Përgatitja dhe njoftimi i rendit të ditës dhe i materialeve bëhen në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit.

Neni 35

Vlefshmëria e mbledhjes dhe e vendimeve të Bordit të Administrimit

(ndryshuar pika 6 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Mbledhjet e Bordit të Administrimit drejtohen nga Kryetari.
2. Mbledhjet janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve të Bordit të Administrimit. Në rast se në mbledhje janë të pranishëm më pak se gjysma e anëtarëve, atëherë mbledhja nuk zhvillohet dhe shtyhet për një datë tjetër, por jo më vonë se tri ditë, dhe sipas përcaktimeve të rregullores së organizimit dhe funksionimit të Bordit të Administrimit.
3. Anëtarët e Bordit të Administrimit e ushtrojnë vetë funksionin e tyre. Ata nuk mund t'ia delegojnë votën një anëtari tjetër dhe as të votojnë në emër të një anëtari tjetër.
4. Votimi në Bordin e Administrimit është i hapur.
5. Bordit i Administrimit merr vendime me shumicë të thjeshtë, me përjashtim të rasteve kur për marrjen e vendimeve kërkohet një shumicë e cilësuar, sipas përcaktimeve në këtë Statut.
6. *Vendimet e Bordit të Administrimit, zbardhen nga sekretaria, nënshkruhen nga Kryetari dhe si rregull hyjnë në fuqi menjëherë. Bordi i Administrimit mund të përcaktojë në vendim kohën e hyrjes në fuqi të tij.*

Neni 36

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhjen e Bordit të Administrimit

1. Rektori dhe Administratori i Institucionit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit të Administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky Bord.
2. Në mbledhjen e Bordit të Administrimit, mund të thirren specialistë të fushave të ndryshme, që kanë dijeni mbi çështjet të cilat janë shtruar për diskutim. Specialistët mund të jenë të brendshëm apo të jashtëm.
3. Administratori i Kolegjit cakton një person për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve.

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të 'Institutit Kanadez I Teknologjisë'

Tiranë 2016, I ndryshuar



4. Pjesë e sekretarisë teknike do të konsiderohen edhe persona të tjerë, punonjës të administratës të cilët japin shpjegime gjatë mbledhjes, lidhur me materialet e paraqitura dhe çështjet që diskutohen.

Seksioni IX

REKTORI

Neni 37

Rektori

(ndryshuar pika 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit, si edhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori duhet të ketë titullin "Profesor" dhe zgjidhet për një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë në të njëjtin pozicion dhe institucion.

Neni 38

Funksionet dhe kompetencat e Rektorit të Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"

(-ndryshuar shkronja a), d), e) pika 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

- shfuqizuar shkronja o) pika 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Rektori i Kolegjit ka këto funksione:
 - a. Drejton dhe përfaqëson Kolegjin në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike.
 - b. Është anëtar i Konferencës së Rektorëve.
 - c. Është Kryetar i Senatit.
 - d. Ushtron kontrollin e ligjshmërisë mbi autoritetet drejtuese të njësive kryesore.
 - e. Lëshon diploma për përfundimin e programeve të studimit, që janë organizuar në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë".
2. Rektori i Kolegjit ushtron edhe këto kompetenca:

Propozon emrin e Zëvendësrektorit/rëve për miratim në Senatin Akademik dhe e/i emëron atë/ata pas miratimit;

 - a. Emëron Dekanët e Fakulteteve;
 - b. Vendos për hyrjen e Kolegjit në lidhje me shkolla të larta të vendit dhe të huaja, shoqata e organizata të ndryshme, për shkëmbim përvoja dhe bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor, si dhe për kualifikimin e punonjësve akademikë;

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të 'Institutit Kanadez I Teknologjisë'

Tiranë 2016, I ndryshuar



- c. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga një autoritet drejtues i një njësie kryesore, rektori urdhëron shkarkimin e tij;
- b) cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të shkarkuar deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, sipas Ligjit në fuqi;
- c) Rektori organizon zgjedhjet e zakonshme dhe të parakohshme;
- d) Miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit *akademik*;
- e) Miraton punonjësit mësimorë shkencorë të cilët për vitin *akademik* do të jenë nën ngarkesën vjetore të normës mësimore, duke përcaktuar për çdo rast këtë ngarkesë;
- f) Emëron punonjësit mësimorë e shkencorë, drejtuesit e strukturave si dhe specialistët e lartë, duke iu përmbajtur kriterëve për zënien e këtyre vendeve, sipas përcaktimeve të njërive përkatëse, si dhe nënshkruan kontratat e punës së punonjësve të emërtesës së tij, sipas përcaktimeve të njërive përkatëse, si dhe i shkarkon ata në rastet e parashikuara me ligj, në përputhje me këtë Statut dhe akte të tjera;
- g) Ngre komisione të cilëve ju ngarkon detyra të veçanta;
- h) Nxjerr urdhra të brendshëm për veprimtarinë e përditshme të administratës së Kolegjit, si dhe vendos masa disiplinore dhe administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë Statut;
- i) Deleton firmën nëpunësve të tjerë në vartësi të tij, për kryerjen e detyrave të caktuara, kur e çmon të arsyeshme;
- j) Vendos përjashtimin nga Kolegji të studentëve për rastet e parashikuara në Rregulloren përkatëse të studentëve;
- k) Jep leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset e Kolegjit dhe mund t'u bëjë apel këtyre forcave në rast nevojë;
- l) Rektori i Kolegjit kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Kolegjit apo akte të tjera;
- m) Monitoron dhe apelon procesin e rekrutimit të stafit akademik;
- n) Përcakton dhe bën publike afatet, kriteret dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik;
- o) *shfuqizuar*;
- p) Shpall fushatën e rekrutimeve me detajim të vendeve vakante.

Neni 39

Zgjedhja, mandati, emërimi dhe shkarkimi i Rektorit

(- ndryshuar pika 1, 5 dhe 6 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

- shfuqizuar pika 4 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

1. Rektori i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, zgjidhet me votim të fshehtë nga anëtarët e Senatit Akademik, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe sipas

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të ‘Institutit Kanadez I Teknologjisë’

Tiranë 2016, I ndryshuar



- procedurave të përcaktuara në *Rregulloren e Zgjedhjeve* në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
2. Për postin e Rektorit mund të konkurrojnë individë nga rradhët e personelit akademik të Kolegjit ose individë jashtë saj me titull “Profesor”. Këta të fundit, në rastin kur rezultojnë fitues, bëhen anëtarë të personelit akademik të Institucionit.
 3. Rektori i Kolegjit zgjidhet për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë në të njëjtin pozicion dhe institucion.
 4. *shfuqizuar*.
 5. *Në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në rregulloret e brendshme të institucionit, Senati Akademik shkarkon Rektorin.*
 6. *Me vendim të Senatit Akademik, Zv. Rektori zëvendëson rektorin e shkarkuar, për një afat deri në 6 muaj, me qëllim organizimin e zgjedhjeve në institucion.*

Neni 40

Përfundimi i mandatit të Rektorit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
(*shfuqizuar shkronja “ç” , pika 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025*)

1. Mandati i Rektorit të Kolegjit, përfundon me mbarimin e periudhës për të cilën është zgjedhur.
2. Mandati i Rektorit mund të përfundojë në mënyrë të parakohshme kur ai:
 - a. Jep dorëheqjen;
 - b. Ndërron jetë;
 - c. Bëhet e pamundur nga ana fizike ose mendore të ushtrijë funksionin;
 - ç. *shfuqizuar*;
 - d. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
3. Në rastet e përcaktuara nga ky nen, shpallen zgjedhje të parakohshme për zgjedhjen e Rektorit.

Seksioni X

DEKANI I FAKULTETIT NË KOLEGJIT UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

Neni 41

Dekani

1. Dekani është autoriteti drejtues në një Fakultet të Kolegjit, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij.
2. Dekani, është personel akademik i kategorisë "Profesor".



Neni 42

Funksionet dhe kompetencat e Dekanit

(shfuqizuar shkronja “j” , pika 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Dekani ka këto funksione:
 - a. Drejton dhe përfaqëson Fakultetin;
 - b. Është anëtar i Senatit;
 - c. Ushtron kontrollin e ligjshmërisë mbi autoritetet drejtuese brenda fakultetit.
2. Dekani ushtron edhe këto kompetenca:
 - a. Propozon emrin e Zëvendësdekanit për miratim në Këshillin e fakultetit dhe e emëron atë pas miratimit;
 - b. Emëron drejtuesit e njësive bazë të fakultetit përkatës;
 - c. Emëron përgjegjësit e grupeve mësimore lëndore dhe ndërlëndore mbi propozimin e titullarit të njësisë bazë;
 - d. Organizon regjistrimin e studentëve sipas programeve të studimit në fakultet, në përputhje me kriteret dhe procedurat e miratuara për këtë qëllim;
 - e. Mbikëqyr mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore dhe shkencore në njësitë bazë, duke koordinuar dhe bashkëpunuar me drejtuesit e njësive bazë;
 - f. Miraton komisionet e provimeve të formimit, e mbrojtjes së diplomave për programet e studimit që mbulon dhe çdo komision tjetër në ndihmë të realizimit të detyrave dhe funksioneve të fakultetit;
 - g. Në bazë të nevojave të fakultetit dhe zhvillimit të tij, i propozon Rektorit vendet vakante dhe ndryshimet në numrin dhe pozicionet e burimeve njerëzore të fakultetit, për përgatitjen e procesit të rekrutimit;
 - h. Ngre komisionin *ad hoc* të rekrutimit për fakultetin përkatës;
 - i. Drejton procesin e rekrutimit për fakultetin përkatës në bazë të planit të Rektorit për këtë proces;
 - j. *shfuqizuar*;
 - k. I propozon Rektorit përjashtimin e studentëve, për rastet e parashikuara në Rregulloren e Fakultetit;
 - l. I paraqet rektoratit, për çdo vit, raportin për aktivitetin mësimor, shkencor dhe financiar të fakultetit, pas diskutimit dhe miratimit paraprak në dekanat;
 - m. Organizon konkurset e pranimeve të studentëve të rinj në fakultet dhe kontrollon mirëfunksionimin e komisioneve të pranimeve;
 - n. Miraton rregulloret e brendshme të njësive në përbërje të fakultetit;
 - o. Në bazë të numrit të studentëve dhe të angazhimeve të fakultetit i propozon Rektorit hapjen e vendit në fakultetin përkatës;
 - p. Miraton kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të provimeve, të pranimeve, të provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomave, tezat e provimeve të pranimit, të provimeve të



formimit dhe temat e projekt – diplomave, projektet dhe planet e kërkimit të punonjësve shkencorë të qendrës përkatëse të kërkimit ose të njësive bazë të mësim – kërkimit pas shqyrtimit në dekanat, me propozim të titullarit të njësisë bazë;

- q. Shpall rezultatet e konkurseve të pranimit;
- r. Dekani në ushtrim të kompetencave, shprehet me urdhra dhe udhëzime.
- s. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga titullari i një njësie bazë apo Këshilli i Etikës, i propozon Rektorit shkarkimin e tij. Rektori shprehet brenda një muaji.
- t. Dekani cakton njërin prej përgjegjësve të grupeve kërkimore-shkencore ose mësimore lëndore apo ndërlëndore, që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të pezulluar deri në emërimin e autoritetit të ri.

3. Dekani kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Kolegjit apo akte të tjera.

Neni 43

Zgjedhja, mandati, emërimi dhe shkarkimi i Dekanit

(ndryshuar pika 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Dekani emërohet nga Rektori në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.
2. Për postin e Dekanit mund të aplikojnë ose konkurojnë individë të personelit akademik të fakultetit përkatës ose individë jashtë tij që i përkasin kategorisë “Profesor”. Këta të fundit, në rastin kur rezultojnë fitues, bëhen anëtarë të personelit akademik të fakultetit përkatës.
3. Dekani i Fakultetit emërohet për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë në të njëjtin pozicion dhe institucion.
4. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga një Dekan, Rektori urdhëron shkarkimin e tij. Rektori cakton zëvendësdekanin ose njërin prej zëvendësdekanëve kur janë më shumë se një, që do ta zëvendësojë dekanin e shkarkuar deri në emërimin e dekanit të ri.

Neni 44

Përfundimi i mandatit të Dekanit të Fakultetit

1. Mandati i Dekanit përfundon me përfundimin e periudhës për të cilën është zgjedhur.
2. Mandati i Dekanit mund të përfundojë në mënyrë të parakohshme kur ai:
 - a. Jep dorëheqjen;
 - b. Ndërron jetë;
 - c. Bëhet e pamundur nga ana fizike ose mendore të ushtrisë funksionin;
 - ç. Kur vendoset shkarkimi i tij;
 - d. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të 'Institutit Kanadez I Teknologjisë'

Tiranë 2016, I ndryshuar



Seksioni XI

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT / PËRGJEGJËSI I QENDRËS KËRKIMORE SHKENCORE

(ndryshuar togfjalëshi “Drejtor i Qendrës Kërkimore Shkencore” në të gjithë seksionin, me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

Neni 45

Përgjegjësi i Departamentit / Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore

1. Përgjegjësi i Departamentit/ Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore është autoriteti drejtues i një njësie bazë në njësitë kryesore të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
2. Përgjegjësi i Departamentit/ Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore duhet të jetë personel akademik i kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”.

Neni 46

Funksionet dhe kompetencat e Përgjegjësit të Departamentit / Përgjegjësi të Qendrës Kërkimore Shkencore

Përgjegjësi i Departamentit/ Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore ka këto funksione dhe kompetenca:

- a) Drejton dhe përfaqëson njësinë bazë;
- b) Drejton e kontrollon gjithë punën mësimore-edukuese e shkencore në njësinë bazë;
- c) Evidenton për çdo semestër dhe vit akademik, në bazë të kriterëve ligjore, nevojat për staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe ia parashtron këto nevoja Dekanit përaktës dhe Rektorit për të parashikuar rekrutimet e stafit akademik.
- d) Përzgjedh, në bashkëpunim me dekanin, në komisionin përkatës të rekrutimit, përmes një procesi të shpallur dhe transparent, kandidaturat për staf me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme në procesin mësimor.
- e) Merr masa organizative dhe monitoruese për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe kërkimor nga punonjësit e njësisë bazë që ai drejton;
- f) I propozon dekanit anëtarët e komisioneve të provimit të formimit apo edhe të mbrojtjes së diplomës për programet që mbulon njësia bazë e drejtuar prej tij;
- g) Nxit dhe motivon punonjësit në realizimin efikas të detyrave si në procesin mësimor, ashtu edhe në atë kërkimor-shkencor;

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të ‘Institutit Kanadez I Teknologjisë’

Tiranë 2016, I ndryshuar



- h) Kërkon rishikime dhe përmirësime të programeve të studimit, të kurrikulave në bazë të nevojave dhe treguesve akademikë.
- i) I propozon Dekanit përkatës procesin e zhvillimit të praktikave profesionale në shoqëri tregtare (SHPK, SHA) ose/dhe në institucione të tjera.
- j) I propozon Dekanit kriteret për regjistrimin e studentëve, ndërsa ky i fundit i përcjell ato në Senat për miratim;
- k) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Kolegjit apo akte të tjera.

Neni 47

Zgjedhja, mandati, emërimi dhe shkarkimi i Përgjegjësit të Departamentit / Përgjegjësit të Qendrës Kërkimore Shkencore

(ndryshuar pika 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Përgjegjësi i Departamentit/Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore emërohet nga Dekani i fakultetit përkatës në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, pas miratimit të Rektorit.
2. Përgjegjësi i Departamentit emërohet për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë në të njëjtin pozicion dhe institucion.
3. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga përgjegjësi i një departamenti/ Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore, Dekani i propozon Rektorit shkarkimin e tij. Rektori shprehet brenda një muaji. Dekani cakton njërin prej përgjegjësve të grupeve mësimore, kërkimore ose shkencore që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të shkarkuar deri në emërimin e autoritetit të ri.

Neni 48

Përfundimi i mandatit të Përgjegjësit të Departamentit / Përgjegjësit të Qendrës Kërkimore Shkencore

1. Mandati i Përgjegjësit të departamentit/ Përgjegjësit të Qendrës Kërkimore Shkencore përfundon me mbarimin e periudhës për të cilën është zgjedhur.
2. Mandati i Përgjegjësit të departamentit/ Përgjegjësit të Qendrës Kërkimore Shkencore mund të përfundojë në mënyrë të parakohshme kur ai:
 - a. Jep dorëheqjen;
 - b. Ndërron jetë;
 - c. Bëhet e pamundur nga ana fizike ose mendore të ushtrroj funksionin;
 - ç. Kur vendoset shkarkimi i tij;
 - d. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.



Seksioni XII

ZËVENDËSREKTORI DHE ZËVENDËSDEKANI I KOLEGJIT UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

Neni 49

Numri dhe detyrat e e zëvendësrektorit/ëve

1. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, ka zëvendësrektor të emëruar nga Rektori;
2. Zëvendësrektori/ët ushtrojnë këto detyra:
 - a. Zëvendëson Rektorin në raste të mungesës së tij me autorizimin e këtij të fundit;
 - b. Organizon dhe kontrollon punën mësimore-formuese-shkencore në gjithë Kolegjin.
 - c. Ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve e të programeve mësimore në fakultete dhe në departamente;
 - d. Ndjek dhe kontrollon ecurinë e zhvillimit të punës shkencore në qendrat e kërkimit në Kolegj;
 - e. Organizon dhe kontrollon punën për specializimin afatgjatë, brenda dhe jashtë vendit, të personelit mësimor e shkencor të Kolegjit;
 - f. Harton projekt-planin kalendarik të procesit mësimor në shkallë akademike dhe ia paraqet Rektorit për miratim;
 - g. Kontrollon organizimin dhe zhvillimin e konkurseve të pranimit të studentëve të rinj;
 - h. Kontrollon dhe përgjithëson përvojën e fakulteteve dhe të njësive bazë mësimore të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” në procesin mësimor-edukativ;
 - i. Ndjek dhe nxit bashkëpunimin shkencor të njësive të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, me institucione shkencore, shkolla të tjera të larta, firma, ndërmarrje prodhimi, etj;
 - j. Organizon kryerjen e studimeve për zhvillimin perspektiv të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, në fushat që mbulon dhe ia paraqet Rektorit;
 - k. I paraqet Rektorit projektet e mundshme lidhur me punën shkencore;
 - l. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në këtë Statut apo akte të tjera.
3. Rektori i Kolegjit ka të drejtë t’i propozojë Senatit Akademik ndryshimin e numrit të zëvendësrektorëve, duke përcaktuar edhe detyrat përkatëse.

Neni 50

Përzgjedhja, miratimi, emërimi dhe shkarkimi i Zëvendësrektorit në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të ‘Institutit Kanadez i Teknologjisë’

Tiranë 2016, I ndryshuar



1. Zëvendësrektori në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, duhet të ketë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, ose ka gradën shkencore “Doktor” (PhD).
2. Rektori i Kolegjit propozon kandidaturën/at e përzgjedhur/a prej tij për zëvendësrektor në Senatin Akademik.
3. Senati Akademik miraton propozimin/et e paraqitur/a nga Rektori, në mbledhjen e tij të parë.
4. Rektori i Kolegjit emëron Zëvendësrektorin/ët e/të miratuar nga Senati Akademik.
5. Zëvendësrektori në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, shkarkohet nga Rektori, duke ndjekur të njëjtat procedura për emërimin e tij.
6. Zëvendësrektori largohet nga detyra kur:
 - a. Jep dorëheqjen;
 - b. Shkarkohet nga Rektori për shkelje të akteve ligjore e nënligjore apo me veprimet e tij cënon veprimtarinë normale dhe integritetin e Kolegjit;
 - c. Për arsye fizike apo mendore konstatohet pamundësia në kryerjen e detyrave të ngarkuara;
 - ç. Kur dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
7. Në rast shkarkimi të zëvendësrektorit, Rektori, i propozon Senatit Akademik emrin e zëvendësrektorit të ri.

Neni 51

Zëvendësdekani në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

1. Zëvendësdekani emërohet dhe shkarkohet nga Dekani, pas miratimit nga Këshilli i Fakultetit.
2. Zëvendësdekani duhet të jetë lektor i një lënde dhe në marrëdhënie pune në fakultetin përkatës, si dhe të ketë të paktën gradën “Doktor”.
3. Zëvendësdekani ushtron kompetenca të përcaktuara në aktin e emërimit.
4. Zëvendësdekani zëvendëson Dekanin, në rastet kur ky mungon, ose në raste të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Dispozita të tjera lidhur me zëvendësdekanin mund të përcaktohen në Rregulloren e Fakultetit.

Seksioni XIII

ADMINISTRIMI I KOLEGJIT UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

Neni 52

Autoritetet Administruese

1. Autoritete administruese në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, janë:
 - a. Administratori i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
 - b. Administratori/ët i/e Njësisë/ve Kryesore.
2. Autoritetet e tjera emërohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë Statut.

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të ‘Institutit Kanadez i Teknologjisë’

Tiranë 2016, I ndryshuar



Neni 53

Administratori i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të Institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i Institucionit për çështjet financiare dhe administrative.
2. Administratori i institucionit emërohet në detyrë dhe shkarkohet nga detyra nga Bordi i Administrimit me propozim të pronarit (themeluesit) të Kolegjit Universitar. Emërimi dhe shkarkimi bëhen me votim të fshehtë me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Bordit pjesëmarrës në mbledhje.
3. Administratori i institucionit nuk mund të ushtrrojë asnjë funksion tjetër akademik apo administrativ në konflikt interesi me detyrën e tij.
4. Administratori për veprimtarinë e tij i raporton Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik (respektivisht) për përmbushjen e detyrave në fushën financiare e administrative.

Neni 54

Seleksionimi i Kandidaturave

(shfuqizuar shkronja “P” me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr.10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

Nëse propozohet më shumë se një kandidaturë:

- a. Bordi i Administrimit harton skemën e vlerësimit të kandidatëve duke përshkruar me hollësi mënyrën e vlerësimit të tyre.
- b. Përveç vlerësimit të dosjes, Bordi mund të parashikojë e të caktojë, intervistimin e secilit kandidat të propozuar.
- c. Çdo anëtar i Bordit të Administrimit bën vlerësim me shkrim për çdo kandidat dhe në fund, në bazë të vlersimeve, shpallet renditja e kandidatëve.
- d. Në përfundim, kandidati që merr më shumë vota nga anëtarët e Bordit, shpallet kandidat fitues.
- e. Mbas përzgjedhjes së kandidatit për administrator, Bordi i Administrimit e shpall publikisht kandidaturën fituese.
- f. *shfuqizuar.*

5. Administratori kryen këto funksione kryesore:

- a) Harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në Planin Strategjik të Zhvillimit të Institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
- b) Propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;



- c) Ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të Institucionit në strukturat e varësisë së tij;
- d) Zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik, me karakter financiar dhe administrativ;
- e) I paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të Institucionit, në përfundim të çdo viti akademik;
- f) Bashkëpunon me autoritetet dhe strukturat e tjera të Institucionit për çështje të administrimit të përditshëm;
- g) Emëron dhe shkarkon administratorët e fakulteteve dhe gjithë personelin administrativ të institucionit;
- h) Plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
- i) Drejton veprimtarinë e administratës;
- j) Drejton procedurat e marrjes në punë dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të administratës; Nënshkruan kontratat individuale të punës me punonjësit e administratës;
- k) Përfaqëson ose bashkëpërfaqëson Institucionin në të gjitha proceset gjyqësore apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palët e treta, persona fizikë ose juridikë;
- l) Është anëtar i Rektoratit;
- m) Administratori kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në këtë Statut apo në aktet nënligjore.

Neni 55

Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

(ndryshuar shkronja “h”) me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr.10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

Procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e Administratorit të institucionit:

- a) Me propozim të pronarit (themeluesit) të institucionit, Bordi i Administrimit miraton kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët;
- b) Mbi bazën e propozimit të themeluesit, Bordi, kur ka më shumë se një kandidaturë shpall fillimin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së kandidaturave;
- c) Harton skemën e vlerësimit të kandidaturave duke përcaktuar me hollësi mënyrën e vlerësimit të tyre;
- d) Përveç vlerësimit të dosjes mund të parashikohen e të realizohen intervista me secilin kandidat;
- e) Çdo anëtar i Bordit të Administrimit bën vlerësimin, me shkrim, sipas skemës së miratuar, për çdo kandidat, dhe në përfundim, në bazë të pikëve të fituara e grumbulluara, shpallet renditja e kandidatëve;

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të ‘Institutit Kanadez I Teknologjisë’

Tiranë 2016, I ndryshuar



- f) Me votim të fshehtë, Bordi ka të drejtë të përzgjedhë njëjën nga dy kandidaturat që ka grumbulluar më shumë pikë. Fitues shpallet kandidati që merr më shumë vota nga anëtarët e Bordit;
- g) Pas zgjedhjes, Bordi i Administrimit shpall publikisht kandidaturën fituese;
- h) *Procedurat për largimin e Administratorit të institucionit:*
- *Administratori i institucionit largohet nga detyra kur:*
 - *Jep dorëheqjen;*
 - *Shkarkohet nga Bordi i Administrimit.*
 - *Procedurat që ndiqen nga Bordi i Administrimit, për shkarkimin e Administratorit janë:*
 - *Bordi i Administrimit bën vlerësimin me shkrim të Administratorit;*
 - *Anëtarët e Bordit të Administrimit me shumicë votash votojnë shkarkimin e tij.*

Neni 56

Administratori i Njesisë Kryesore

1. Administratori i fakultetit (njësisë kryesore) është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të tij (fakultetit).
2. Administratori i Njesisë kryesore emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga administratori i institucionit. Ai mund të kundërshtojë masat e dhëna ndaj tij, nga administratori i institucionit, sipas dispozitave të Kodit të Punës, të akteve të tjera ligjore e nënligjore dhe përcaktimeve të kontratës së punës.
3. Kur për vendin vakant të administratorit të Njesisë Kryesore paraqitet më shumë se një kandidaturë, administratori i institucionit përveç shqyrtimit të dosjeve mund t'i ftojë kandidatët në bisedë (intervistë) veç e veç.
4. Administratori i Njesisë Kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ në konflikt me detyrën e tij.
5. Administratori i fakultetit, për veprimtarinë e tij i raporton administratorit të institucionit, si dhe informon Dekanin përkatës për gjithçka lidhur me mbështetjen e procesit mësimor dhe atij kërkimor.
6. Funksionet kryesore të administratorit të fakultetit janë:
 - a) realizon administrimin e përditshëm financiar të fakultetit;
 - b) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të fakultetit;
 - c) plotëson kërkesat e Dekanit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
 - d) bashkëpunon me autoritete të tjera në strukturat e fakultetit, për çështje themelore të administrimit të tij;
 - e) kryen funksione të tjera, të parashikura në Rregulloren e Institucionit ose/dhe të Fakultetit.



PJESA E TRETË
PERSONELI I KOLEGJIT UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I
TEKNOLOGJISË”

Neni 57

Personeli i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

1. Personeli i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmësakademik dhe personeli administrativ.
2. Personeli mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.
3. Të drejtat dhe detyrimet e personelit përcaktohen në këtë Statut dhe në akte të brendshme, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU III

PERSONELI AKADEMIK

Neni 58

Statusi i personelit akademik

1. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë nga Ligji.
2. Aspekte të trajtimit të veçantë, si dhe përfitime të tjera të personelit akademik përcaktohen nga Bordi i Administrimit, në përputhje me rregulloren e këtij të fundit.

Neni 59

Kategoritë e personelit akademik

1. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, personeli akademik kategorizohet në:
 - a) profesorë;
 - b) lektorë;
 - c) asistent-lektorë,

Nivelet e pagave të kategorive të personelit akademik miratohen nga Bordi i Administrimit.

3. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Ata mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i Asociuar" dhe punësohen me kontratë pa afat. Personeli akademik i kësaj kategorie, pas mbushjes së moshës së pensionit, punësohen vetëm me kontratë një vjeçare.



4. Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore, të cilët mbajnë gradën shkencore "PhD" ose "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie, para ose pas fitimit të kësaj grade, dhe punësohen me kontratë pa afat.
5. Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore, kanë së paku diplomën "Master i shkencave" dhe punësohen me kontratë me kohëzgjatje të caktuar, së paku njëvjeçare, me të drejtë përsëritje.
6. Ngarkesa mësimore vjetore e stafit akademik caktohet me vendim të Senatit Akademik. Ajo është e diferencuar për kategoritë e personelit akademik të cituara në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

Neni 60

Personeli akademik i ftuar

1. Njësitë bazë të institucionit kanë të drejtë që të ftojnë, për periudha të shkurtra kohe, studiues apo personalitete të fushës, vendas apo të huaj, me kontratë me afat.
2. Për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar ndërthuren kualifikimet e tyre me nevojën e njësisë bazë për veprimtari mësimdhënie ose kërkimore-shkencore.
3. Personeli i ftuar punësohet, rast pas rasti, dhe zhvillimi i mësimit mund të organizohet me kohë të shkurtër sipas një plani të veçantë.

Neni 61

Punësimi i personelit akademik

1. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësi bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori. Përzgjedhja e kandidatit drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë në shumicë nga njësi bazë përkatëse.
2. Komisioni ad-hoc bën renditjen e kandidaturave, ia propozon Rektorit dhe ky i fundit bën emërimin me kohë të plotë të punonjësit.

Neni 62

Personeli administrativ

1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit.
2. Punësimi i personelit administrativ bëhet nga Administratori i Institucionit, pas shqyrtimit të kërkesave të bëra nga kandidatët që kanë aplikuar. Kriteret e punësimit përcaktohen, rast pas rasti, sipas kërkesave të pozicionit të punës.
3. Procedurat për masat disiplinore janë ato që parashikon Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë dhe Kodi i Etikës së Institucionit dhe akte të tjera të tij, duke përfshirë dhe kontratën e punës.



KREU IV

PERSONELI NDIHMËS AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Neni 63

Personeli ndihmës akademik

1. Personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor e ndihmës akademik dhe me karakter administrativ.

1.1 Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor. Ai bën pjesë në stafin e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Këtu përfshihen laborantët, teknikët etj., sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit.

1.2 Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel të institucionit. Këtu përfshihet personeli i përcaktuar në aktet e brendshme të institucionit.

2. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës akademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësia të cilës ky personel i shërben, konkursi drejtohet nga një komision *ad-hoc*, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse.

3. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit *ad-hoc*, si dhe të përzgjedhjes së personelit ndihmës akademik caktohen në aktet e brendshme të institucionit.

Neni 64

Personeli administrativ

(shfuqizuar me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

PJESA E KATËRT

ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 65

Format e studimit dhe programet në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

(ndryshuar pika 4 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ofron programe studimi të ciklit të parë, nëpërmjet të cilit synohet që studentët të pajisen me njohuri të përgjithshme si dhe bazë, mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme.



2. Programet e studimit realizohen me jo më pak se 180 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vjet ose 6 semestra.
3. Pas përfundimit të studimeve universitare të ciklit të parë studentët pajiset me diplomën universitare të ciklit të parë, e cila është e njëvlershme me diplomën “Bachelor”. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ofron programe studimi të ciklit të dytë, nëpërmjet të cilit synohet që studentët të pajisen me njohuritë bazë duke u kualifikuar më tej, mbi metoda dhe parime shkencore.
4. Programet e studimit realizohen me jo më pak se 60 dhe 120 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre për Master Profesional është *1 vit ose 2 vite akademike*; ndërsa për Master i Shkencave 2 vjet.
5. Pas përfundimit të studimeve universitare të ciklit të dytë studentët pajiset me diplomë universitare të ciklit të dytë, e cila është e njëvlershme me diplomën “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”.
6. Pas marrjes së diplomës universitare “Bachelor”, studentët e degëve përkatëse kanë mundësi të ndjekin studimet për njohuri të thelluara, teorike, praktike si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti dhe të fitojnë në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë diplomë të dytë “Master i Shkencave” ose “Master Profesional”.
7. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” e zhvillon aktivitetin e tij akademik në gjuhën angleze. Por kjo nuk përjashton hapjen e programeve të reja të studimit në gjuhën shqipe si në ciklin e parë të studimeve ashtu dhe në ciklin e dytë të tyre.

Neni 66

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, zhvillohen me bazë vitin akademik. Shpallja e datës së fillimit të vitit akademik bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Viti akademik organizohet në dy semestra.
3. Mësimdhënia organizohet në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte kursi dhe praktikë profesionale.

Neni 67

Tarifat e studimeve

1. Tarifat e studimeve përfshijnë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit. Tarifat e studimeve janë të diferencuara sipas cikleve apo formave të studimeve.
2. Tarifat për të gjitha programet e studimeve propozohen nga Administratori dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.
3. Studentët nënshkruajnë kontratat përkatëse të shërbimit, në të cilat përcaktohen dhe tarifat e studimit për të gjitha programet dhe ciklet e studimit.



Kreu V

CIKLI I PARË I STUDIMEVE

Neni 68

Programet e ciklit të parë të studimeve

1. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.
2. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite evropiane (ECTS) (më tej kredite) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike;
3. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Statut.

Neni 69

Pranimi në ciklin e parë të studimeve

(ndryshuar pika 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MAS nr.619, datë 24.12.2025)

1. Çdo person që ka mbaruar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe përmbush kriterin ligjor të notës mesatare, ka të drejtë të konkurojë për t’u pranuar të ndjekë studimet në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
2. Studimet në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, mund t’i ndjekin studentët shqiptar dhe studentë të huaj, si dhe studentë sipas marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.
3. Studimet në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, mund t’i ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar një program studimi në arsimin e lartë kundrejt pagimit të tarifës së caktuar.
4. Kolegji ka të drejtë të propozojë kritere të veçanta të konkurseve të pranimit për çdo specialitet. Këto kritere dhe rregulloret e konkurseve bëhen publike nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, së bashku me informacionin e nevojshëm mbi Fakultetin përkatës, njësinë bazë përkatëse dhe programet që ofrohen.

Neni 70

Elementët e programeve të studimeve të ciklit të parë

1. Programet e studimeve të ciklit të parë duhet të përmbajnë elementet e mëposhtme:
 - a. të dhëna të përgjithshme për programin, formën dhe objektivat kryesore, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve;



- b. kushtet e pranimeve në programin e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes në rastet e pranimeve me numër të kufizuar;
 - c. metodat e vlerësimit të studentëve dhe kushtet për përparim në program;
 - d. kushtet për transferime ndërmjet programeve dhe kushtet për përfundimin e pjesshëm të programit, nëse ai e parashikon këtë gjë;
2. Elementë të tjerë të programeve të studimit mund të përcaktohen nga Senati akademik.

Neni 71

Lëshimi i diplomave dhe dokumenteve të tjera

(ndryshuar pika 2 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Kolegji pajis studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi brenda afateve kohore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.
2. *Diplomat e lëshuara nga institucioni shoqërohen me suplementin e diplomës.*
3. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve, që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës etj.
4. Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga Senati Akademik, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
5. Çdo formë diplome ose çertifikate, përpara se të lëshohet, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

Neni 72

Titujt e diplomave të ciklit të parë në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, lëshon diploma “Bachelor”, për ciklin e parë të studimeve sipas programeve të studimit, në formatin e miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë dhe të regjistruara në Regjistrin shtetëror të diplomave.

Neni 73

Transferimet për ciklin e parë të studimeve

(-ndryshuar pika 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

-shtuar pika 1/1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

-ndryshuar pika 5 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)



1. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, ofron mundësi për transferime të studimeve midis programeve të të njëjtit cikël brenda Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, nga/drejt institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

1/1. Transferimet lejohen vetëm në fillim të vitit akademik

2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon strukturës mësimore që pranon studentin.

3. Kriteret kryesore për njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student janë si më poshtë:

- a. Ngjashmëria e programit të studimit;
- b. Koha e kryerjes së studimeve;
- c. Të jetë i përfshirë në sistemin e Bolonjës.

4. Kriteret kryesore për njohjen e pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student janë si më poshtë:

- a. Ngjashmëria e programit të studimit;
- b. Koha e kryerjes së studimeve;
- c. Të jetë i përfshirë në sistemin e Bolonjës.

5. Kriteret tjerë më të detajuara për njohjen e krediteve sipas pikave 3 e 4 të këtij neni, përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë dhe të programit të studimit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

KREU VI

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE

Neni 74

Programet e ciklit të dytë të studimeve

Programet e ciklit të dytë të studimeve janë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”.

1. Programet e studimeve të ciklit të dytë japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda një specialiteti.

2. Këto programe realizohen me 60 ose 120 kredite ku përfshihen kredite për projektin kërkimor, tezën dhe zgjatja normale e tyre është një ose dy vite akademike.

3. Këto programe studimi zhvillohen në gjuhën angleze, si një nga 5(pesë) gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian, miratuar në aktin përkatës të akreditimit të tyre. Në këtë kuadër studentët e këtyre programeve, kanë detyrimin ligjor të dëshmojnë njohjen e gjuhës angleze, në nivelin përkatës, të vërtetuar me dokument nga institucione të licensuara e njohura prej ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

4. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare “Master i Shkencave” ose “Master Profesional” në fushën e arsimimit të kryer. Lëshimi i diplomave për ciklin e dytë bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij Statuti.



Neni 75

Elementët e programeve të studimeve të ciklit të dytë

1. Programet e studimeve të ciklit të dytë duhet të përmbajnë të njëjtët elemente që përcaktohen për programet e studimit të ciklit të parë.
2. Elementë të tjerë të programeve të studimit të ciklit të dytë mund të përcaktohen nga Senati akademik.

Neni 76

Pranimi në ciklin e dytë të studimeve

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, si dhe plotësojnë standardet akademike të kriterëve të pranimit të Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë".
2. Kuotat dhe kriteret e pranimit në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", për programet e studimeve të ciklit të dytë, miratohen nga Senati Akademik.

Neni 77

Transferimet për ciklin e dytë të studimeve

(-shtuar pika 1/1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

-ndryshuar pika 5 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1.Kolegji ofron mundësi për transferime të studentëve midis programeve të ciklit të dytë, brenda Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", apo nga/drejt institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

1/1.Transferimet lejohen vetëm në fillim të vitit akademik;

2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon strukturës mësimore që pranon studentin.
3. Kriteret kryesore për njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student janë si më poshtë:
 - a. Ngjashmëria e programit të studimit;
 - b. Koha e kryerjes së studimeve;
 - c. Të jetë i përfshirë në sistemin e Bolonjës.
4. Kriteret kryesore për njohjen e pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student janë si më poshtë:
 - a. Ngjashmëria e programit të studimit;

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të 'Institutit Kanadez I Teknologjisë'

Tiranë 2016, I ndryshuar



- b. Koha e kryerjes së studimeve;
 - c. Të jetë i përfshirë në sistemin e Bolonjës.
5. Kriteria të tjera më të detajuara për njohjen e krediteve sipas pikave 3 e 4 të këtij neni, përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë dhe të programit të studimit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Neni 78

Titujt e diplomave të ciklit të dytë në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
(-ndryshuar pika 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Kolegji lëshon diploma për ciklin e dytë të studimeve të shoqëruara me suplementet përkatëse sipas programeve të studimit në secilin prej fakulteteve.
2. Diplomat për çdo fakultet lëshohen në përputhje me titujt e miratuar nga autoritetet kompetente. Titujt e diplomave mund të ndryshojnë në varësi të miratimeve sa më sipër.

Neni 79

Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë

Organizimi dhe rregullat për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë miratohen nga autoritetet kompetente shtetërore.

KREU VII

PROGRAMI I DYTË I STUDIMIT

Neni 80

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi.
2. Individët që duan të ndjekin një program të dytë studimi duhet të përmbushin të gjitha kriteret e pranimit në këtë program studimi si ata që regjistrohen për herë të parë.



KREU VIII

PROGRAME TË TJERA

Neni 81

Programet e studimeve ndërdisiplinore

1. Fakultetet në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, mund të organizojnë programe të përbashkëta të studimeve ndërdisiplinore.
2. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, mund të organizojë programe studimi ndërdisiplinore me institucione të tjera, të ndryshme, të arsimit të lartë.
3. Në përfundim të programeve të studimeve ndërdisiplinore lëshohet diplomë e përbashkët nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” dhe nga institucioni tjetër i arsimit të lartë.

Neni 82

Programet e studimeve të përbashkëta

1. Programet e studimeve të përbashkëta realizohen në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, ose në një prej fakulteteve të Kolegjit në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
2. Programet e studimeve të përbashkëta organizohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë.

Neni 83

Programet e studimeve të formimit të vazhduar

(-ndryshuar pika 5 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, ofron programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive. Ato mund të jenë dhe programe të kërkimit të avancuar.
2. Programet e studimeve të formimit të vazhduar ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit të tyre dhe të aftësive profesionale.
3. Në kuadër të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, Kolegji organizon edhe forma të tjera të ndryshme të mësimin informal si kurse, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme.



4. Struktura e programeve, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen nga Kolegji në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Statut për programet e studimit.

5. Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, Kolegji lëshon çertifikatat përkatëse, të cilat regjistrohen në përputhje me ligjin.

KREU IX

NJOHJA DHE EKVIVALENTIMI I DIPLOMAVE DHE PERIUDHAVE TË STUDIMIT

Neni 84

Njohja e diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të huaj

(-shfuqizuar fjalia e fundit në pikën 2: “Ministria ka të drejtë të autorizojë Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, për kryerjen e këtij procesi, për raste të njësimi të diplomës nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin.”, me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025; miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Nëpërmjet procedurës së njohjes, një diplomë e huaj njësohet me një diplomë shqiptare nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin dhe e së drejtës për punësim. Kjo vlen dhe për njohjen e certifikatave, gradave ose titujve të huaj.

2. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të diplomave ose certifikatave, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, është ministria përgjegjëse për arsimin, e cila e kryen këtë proces nëpërmjet njësisë përgjegjëse të njohjes së diplomave.

Neni 85

Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve

(-ndryshuar pika 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

- në pikën 2 zëvendësohet fjala “Ekuivalentimi” si dhe shtohet fjalia “Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, me qëllim vazhdimin e studimeve i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësisia bazë” me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025;

- ndryshuar pika 3 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.

2. Njohja e krediteve bëhet nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, me qëllim vazhdimin e studimeve i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm, si dhe procedurat për njohjen e krediteve përcaktohen në këtë Statut, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PJESA E PESTË

KËRKIMI SHKENCOR

KREU X

Neni 86

Kërkimi shkencor dhe zhvillimi

1. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, mund të kryej kërkim shkencor, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese, sipas objektivave specifike të Kolegjit. “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, synon dhe në rritjen e cilësisë së arsimimit. Ai u jep studentëve aftësi metodologjike për kërkim, jep mundësi të vazhdueshme në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri të avancuara, përmirëson kualifikimet e personelit akademik, si dhe krijon mjete materiale.
2. Personeli akademik është i lirë të kryejë veprimtari kërkimi e zhvillimi për të tretë, por me kusht:
 - a. plotësimin e detyrimeve sipas kontratës së punës;
 - b. plotësimin e detyrimeve të fakultetit apo departamentit përkatës për kërkim shkencor.
4. Veprimtaritë e kërkimit e zhvillimit për të tretët, realizohen në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, vetëm në kuadër të marrëveshjeve me subjekte shtetërore apo private, vendase apo të huaja, në të cilat është palë Kolegji.
5. Marrëveshjet miratohen nga Bordi i Administrimit në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Statut.

Neni 87

Veprimtaritë kërkimore

1. Veprimtaritë e kërkimit dhe zhvillimit duhet të sigurojnë integrimin e kërkimit me mësimin.
2. Temat ose afatet e kërkimit, drejtimet dhe vëllimi i punëve përcaktohen nga njësitë bazë dhe kryesore në bazë të procedurave të përcaktuara në rregulloren e kërkimit shkencor. Këto përcaktohen mbështetur në nevojat e zhvillimit të vendit, rëndësinë e kërkimit për arsimimin e studentëve, programet e bashkëpunimit shkencor, aftësimin e personelit akademik, objektivat strategjike të institucionit, si dhe burimet financiare në dispozicion.

3. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, kryen për të tretë edhe shërbime të ndryshme të kualifikuara, si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime informacioni etj., në përputhje me rregulloret e fakulteteve.
4. Këto veprimtari kryhen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari konsiderohen të ardhura nga Institucioni. Një pjesë e këtyre të ardhurave mund të përdoren edhe për shpërblimin dhe motivimin e personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Kolegji ka të drejtë të hartojë programe dhe projekte kërkimore të bashkëpunimit me institucione të tjera, publike ose private, brenda dhe jashtë vendit, si dhe me shoqata, fondacione etj.
6. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, përgatit një raport vjetor për veprimtarinë kërkimore-shkencore ose krijuese të çdo lloji.

Neni 88

Planifikimi i veprimtarive kërkimore

1. Veprimtaritë kërkimore zhvillohen mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara, nga njësitë bazë dhe kryesore, të iniciuara dhe nga Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, aplikimet dhe inovacionin.
2. Performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve e niveleve vlerësohet nga Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, aplikimet dhe inovacionin dhe nga Senati Akademik, në përputhje me rregullat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të këtij Statuti.
3. Programet e studimeve të ciklit të dytë konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen gjithashtu planifikimit.

PJESA E GJASHTË

SIGURIMI I CILËSISË NË KOLEGJIN UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

KREU XI

CILËSIA E MËSIMDHËNIES

Neni 89

Sigurimi i jashtëm i cilësisë

Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit, në përputhje me afatet, procedurat dhe nga autoritetet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.



Neni 90

Akreditimi

(-ndryshuar pika 3 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Akreditimi kryhet në përputhje me procedurat, afatet dhe nga organet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
2. Çdo program/institucion i akredituar i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik.
3. *Vlefshmëria e cdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet.*
4. Shpenzimet për vlerësimin e jashtëm të cilësisë përballohen nga vetë institucioni.
5. Rezultatet e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit bëhen publike.

PJESA E SHTATË

BUXHETI, ÇËSHTJE FINANCIARE DHE TË PRONËSISË

KREU XII

Neni 91

Parime të përgjithshme

1. Të ardhurat e krijuara nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, përdoren tërësisht prej tij dhe pjesa e papërdorur e tyre mbartet në vitin pasardhës.
2. Të gjitha transaksionet e arkëtimit, përfshirë dhe ato të pagesave kryhen nëpërmjet sistemit bankar, duke respektuar të gjitha rregullat e kontrollit financiar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 92

Burimet e financimit

1. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, financohet nga:
 - a. Kapitali i themeluesit dhe pasuri të tjera të vëna në dispozicion prej tij;
 - b. Të ardhura të krijuara;
 - c. Donacione;
 - d. Burime të tjera të ligjshme.
2. Kolegji miraton rregulloren mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat.

Neni 93

Të ardhurat e Kolegjit

1. Në të ardhurat e Kolegjit përfshihen:

- a. tarifata e studimeve;
- b. të ardhura nga organizimi i trajnimeve ose kualifikimeve për të tretë, sipas marrëveshjeve të lidhura;
- c. të ardhura nga shërbimet në fushën e botimeve, prodhimit të dokumentareve, kërkimeve të ndryshme me interes komunitar etj.
- ç. të ardhura nga kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimeve të tjera të specializuara;
- d. të ardhura që krijohen nga dhënia e aktiveve në përdorim të palëve të treta në trajtën e kontratave të qiradhënies dhe me forma të tjera kontraktimi;
- dh. dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike dhe private;
- ë. financime të tjera të ligjshme.

Neni 94

Hartimi i buxhetit të Kolegjit

(-ndryshuar pika 1 me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. *Projektbuxheti i Kolegjit hartohet nga Administratori, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përbërëse, si dhe miratohet në Senatin Akademik. Me propozim të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit miraton buxhetin e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.*

2. Hartimi i buxhetit bëhet në përputhje me standardet e vendosura nga kuadri ligjor në fuqi.

Neni 95

Pronat e luajtshme dhe të paluajtshme të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

Pronat e luajtshme dhe të paluajtshme të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë, kalojnë në administrim të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, nga Shoqëria “CIT” sh.p.k.

Neni 96

Kontrolli dhe auditimi i jashtëm

Kontrolli dhe auditimi i jashtëm i Kolegjit kryhet nga auditues të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave dhe kundrejtë tarifave të miratuara nga Ministria e Financave.

*Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të ‘Instituti Kanadez i Teknologjisë’
Tiranë 2016, I ndryshuar*



PJESA E TETË STUDENTËT

KREU XIII STUDENTËT DHE TË DHËNAT MBI STUDENTËT

Neni 97

Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit

(-në pikën 3 shfuqizuar pjesa e fjalisë: “pranë Kolegjit Universitar ‘Instituti Kanadez i Teknologjisë.’, si dhe shtohet fjalia në fund: “Bëjnë përjashtim nga ky nen studentët e shkëlqyer.” me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”. Ky status humbet me marrjen e diplomës ose çertifikatës përkatëse, si dhe në rastin e çregjistrimit të studentit nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
2. Studenti mund t'i pezullojë studimet dhe t'i rifillojë ato, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
3. *Studenti nuk mund të regjistrohet, njëkohësisht, në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim nga ky nen studentët e shkëlqyer.*

Neni 98

Të drejtat dhe detyrimet e studentit

1. Studentët kanë të drejtë:
 - a) të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku ata janë të regjistruar;
 - b) të përdorin infrastrukturën, që Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojë shërbimet mbështetëse që ofron ky institucion;
 - c) të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së Kolegjit, në përputhje me përcaktimet e Ligjit dhe të këtij Statuti;
 - d) të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”;
 - e) të nënshkruajnë kontratë shërbimi në momentin e regjistrimit në Kolegj, e cila ka elementet dhe formën që përcaktohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin;
 - f) të sigurohen nga Kolegji në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas

përcaktimeve të bëra në udhëzimin e përbashkët të ministrit të arsimit dhe sportit dhe të ministrit të financave.

2. Studentët kanë për detyrë:

- a) të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”;
- b) të respektojnë të drejtat e personelit dhe të drejtat e studentëve të tjerë;
- c) të paguajnë tarifat e përcaktuara nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”;
- d) të respektojnë Kodin e Etikës.

Neni 99

Këshilli Studentor

(ndryshohet titulli dhe në gjithë përmbajtjen e nenit togfjalëshi “Qeveria Studentore” zëvendësohet me togfjalëshin “Këshilli Studentor”, me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA nr.619, datë 24.12.2025)

1. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore ose qeveri studentore në nivel fakulteti, në nivel kolegji, si dhe në nivel kombëtar.
2. *Këshillat studentor* janë organizime të pavarura. Ato nuk zhvillojnë veprimtari politike, as ekonomike. Ato promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
3. *Këshillat studentor* zgjidhen çdo dy vjet nga vota e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Mandatet e liruara (kur studenti mbaron studimet apo transferohet, si dhe raste të tjera) plotësohen, për kohën deri në përfundim të mandatit të nisur, nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit.
4. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e *Këshillave studentor* përcaktohen në rregulloren e *Këshillit studentor* në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, mbështetur edhe në propozimet e paraqitura nga vet studentët.
5. *Këshillat studentor* shprehin mendime dhe bëjnë propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” dhe të fakultetit përkatës, siç janë ato për planet dhe programet e studimeve; për hapjen e programeve të reja; për rregulloret e veprimtarisë mësimore; për cilësinë e shërbimeve; për nivelin e tarifave të shkollimit; për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.
6. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” mbështet *Këshillat studentor* dhe financon veprimtaritë e tyre nga fondi i caktuar për këto qëllime në buxhetin vjetor të tij.

Neni 100

Dokumentacioni i procesit mësimor

1. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është i detyruar nga Ligji të mbajë në formë të shkruar regjistrat e marrë nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe më konkretisht:

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të Institutit Kanadez i Teknologjisë”

Tiranë 2016, I ndryshuar



- a) regjistrin themeltar të studentëve;
 - b) regjistrin e arritjeve akademike;
 - c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave.
2. Regjistri themeltar i studentëve është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”. Ky regjistër:
- a) tregon që çdo student është pajisur me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose çertifikatës;
 - b) depozitohet në Arkivën e Shtetit, sipas kuadrit Ligjor në fuqi, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” apo vijimësisë së këtij institucioni me emër të ndryshuar, pa të drejtën e lëshimit të ekstrakteve nga regjistri që nga dita e dorëzimit të tij në Arkivën e Institucionit;
 - c) plotësohet edhe në formë elektronike.
3. Regjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” sipas programeve të studimit. Regjistri i arritjeve akademike:
- a) depozitohet në Arkivën e Shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit, pa të drejtën e lëshimit të ekstrakteve nga regjistri që nga dita e dorëzimit të tij në Arkivën e Institucionit.
 - b) plotësohet edhe në formë elektronike.
4. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave është dokumenti që vërteton emetimin e tyre nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”. Në këtë regjistër dokumentohet tërheqja e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale me Kolegjin.
- Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave:
- a) depozitohet në Arkivën e Shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” pa të drejtën e lëshimit të ekstrakteve nga regjistri që nga dita e dorëzimit të tij në Arkivën e Institucionit;
 - b) plotësohet edhe në formë elektronike.
5. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, duhet të plotësojë elementet e regjistrave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me aktet nënligjore. Dokumentacioni pas plotësimit përfundimtar të tij, depozitohet në Arkivën e Shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat. Ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet në arkivin e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e Kolegjit pa të drejtën e lëshimit të ekstrakteve nga regjistri që nga dita e dorëzimit të tij në Arkivë. Në rastin e mbylljes së veprimtarisë së Kolegjit, regjistrat e tij, sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij neni, dhe çdo dokument tjetër, depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor për arkivat.



Të gjitha përcaktimet dhe rregullimet e tjera, do të parashikohen në rregulloren e dokumentacionit të procesit mësimor dhe institucional të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Neni 101

Baza e të dhënave të studentëve në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, ruan të dhënat personale të studentëve, sipas kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

1. Proçeset e ruajtjes dhe të përpunimit të të dhënave të studentëve prej Kolegjit dhe strukturave përbërëse të tij do të kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

PJESA E NËNTË DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

KREU XIV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 102

Miratimi i statutit

1. Ky statut miratohet nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, me 2/3 pro të votave të të gjithë anëtarëve të tij.
2. Statuti i Kolegjit mund të ndryshohet, sipas procedurave dhe me shumicën e kërkuar në këtë Statut.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet çdo akt tjetër me fuqi të njëjtë në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, si dhe çdo dispozitë e rregulloreve apo akteve të tjera, që janë në kundërshtim me këtë Statut.

Neni 103

Dispozitat tranzitore

1. Studentët e regjistruar në një program studimi pranë Shkollës së lartë universitare private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, para hyrjes në fuqi të këtij Statuti, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi për kohëzgjatjen normale të tij.
2. Dispozitat tranzitore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë, janë të zbatueshme në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, pavarësisht përcaktimeve në këtë Statut.

3. Dispozitat e Statutit që janë në kundërshtim me dispozitat kalimtare të legjislacionit në fuqi, nuk janë të zbatueshme. Këto dispozita të Statutit hyjnë në fuqi, në momentin e përfundimit të efekteve ligjore të dispozitave kalimtare, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 104

Vula e institucionit

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, ka vulën zyrtare sipas modelit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij statuti si *Shtojca 3*, me këtë përshkrim: në formë rrethore ka mbishkrimin Republika e Shqipërisë, Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” dhe mbishkrimin në gjuhën angleze “Canadian Institute of Technology”. Poshtë ka vendndodhjen, Tiranë.

Neni 105

Hartimi i rregulloreve të brendshme

Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe me këtë Statut, hartohen dhe rregulloret e përcaktuara në këtë Statut dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 106

Miratimi nga Senati Akademik

Ky Statut u miratua në mbledhjen e Senatit Akademik me Vendim nr. 69, datë 21.09.2016.

Neni 107

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi, ditën e nesërme të miratimit të tij nga ministri përgjegjës për arsimin.

Neni 108

Statuti i miratuar me vendim Nr. 16, datë 11.08.2014 të Senatit Akademik të “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij statuti.

Kryetari i Senatit Akademik
Prof. Dr. Ismail Kocayusufoglu

Miratuar me Vendimin nr. 69, date 21.09.2016 të Senatit Akademik të “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
Tiranë 2016, I ndryshuar




Shtojca Nr. 1; Logo e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"




ORGANIGRAMA E KOLEGJIT UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

Shtojca nr.2 zvendësuar me shtojcën me të njëjtën nr, me Vendim Bordi Administrimi nr.08, datë 28.10.2025, Vendim Senati Akademik nr. 10, datë 04.11.2025, miratuar me Urdhër MA. nr.619, datë 24.12.2025



[Handwritten signature]

Shtojca: Nr. 3 VULA E INSTITUCIONIT



[Handwritten signature in blue ink]